



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 139

Tiranë – E mërkurë, 29 korrik 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 92/2020 datë 16.7.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 16/2018 “Për Diasporën”... 8479
Dekret i Presidentit nr. 11564, datë 24.7.2020	Për shpallje ligji..... 8480
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 22.7.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 446, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar..... 8480
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 22.7.2020	Për një shtesë në vendimin nr. 591, datë 5.9.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e personaliteteve të tjera të larta shtetërore të vendit, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”..... 8480
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 572, datë 22.7.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 445, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë”..... 8480
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 573, datë 22.7.2020	Për krijimin e bazës së të dhënave të sistemit të krahasimit dhe vlerësimit të sigurt të identifikimit personal (PISCES) dhe shkëmbimin e të dhënave me sistemin total të menaxhimit (TIMS)..... 8481
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 22.7.2020	Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal, të rishikuar, për periudhën 2021–2023..... 8482
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 22.7.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 117, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”..... 8493
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 576, datë 22.7.2020	Për disa ndryshime në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar. 8495

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 577, datë 22.7.2020	Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021–2023.....	8495
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 22.7.2020	Për përcaktimin e listës së profesioneve zejtare.....	8502
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 579, datë 22.7.2020	Për përcaktimin e institucioneve publike që administrojnë strehët, të kriterëve, procedurave dhe kapaciteteve të mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike, si dhe të procedurave të administrimit e të mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme, kompetencave të subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre.....	8505
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 22.7.2020	Për procedurat e blerjes nga tregu, të vlerësimit e të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit, familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët, në varësi të nivelit të të ardhurave të tyre.....	8507
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 22.7.2020	Për një shtesë në vendimin nr. 570, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”.....	8514
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 587, datë 22.7.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar.....	8514
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 588, datë 22.7.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 441, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projekteve për miratimin e lejeve të ndërtimit, për ndërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë”.....	8515
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 22.7.2020	Për dhënien e miratimit për një ndryshim në kontratën e qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, të miratuar me vendimin nr. 642, datë 2.10.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.....	8515
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 591, datë 24.7.2020	Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2020.....	8517
Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 15.7.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 8, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të dhënies të së drejtës subjekteve juridike për marrjen në dispozicion të sipërfaqeve të parashikuara për ndërtimin e objekteve e zhvillimin e veprimtarisë përkatëse në zonën energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës”.....	8518

Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 1.7.2020	Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar.....	8519
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 11, datë 17.7.2020	Për miratimin e rregullave për modalitetet, afatet dhe mënyrën e caktimit të përmbaruesit gjyqësor privat zëvendësues.....	8523
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 12, datë 17.7.2020	Për caktimin e procedurës dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbaruesi gjyqësor privat dhe/ose zyrat e përmbarimit privat, të arkivit dhe të vulës personale.....	8525
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 13, datë 17.7.2020	Për miratimin e kriterëve, procedurave të përzgjedhjes dhe shpërblimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur, të cilët angazhohen në kryerjen e kontrolleve.....	8526
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 219, datë 17.7.2020	Për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e arkivit nga përmbaruesi gjyqësor privat.....	8529
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 244, datë 21.7.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Mehmet Akif”, Tiranë.....	8530
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 144, datë 27.7.2020	Për delegim kompetencash.....	8531



LIGJ
Nr. 92/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 16/2018
“PËR DIASPORËN”

Në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 16/2018 “Për diasporën” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”.

Pika 6 e këtij neni bëhet pika 7.

Pika 7 e këtij neni bëhet pika 8.

Pika 8 e këtij neni bëhet pika 9.

Pika 9 e këtij neni bëhet pika 10.

Neni 2

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Komiteti Shtetëror për Diasporën

Komiteti Shtetëror për Diasporën është organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave dhe veprimtarive shtetërore në fushën e diasporës. Ai drejtohet nga Kryeministri. Krijimi, organizimi, mënyra e funksionimit të Komitetit Shtetëror për Diasporën miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

Shkronja “ë” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“ë) propozon dhënien e bursave studentëve nga komunitetet shqiptare të diasporës për të studiuar në universitetet e Republikës së Shqipërisë. Ato miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Shkronja “ë” e këtij neni bëhet shkronja “f”.

Neni 4

Në nenin 9 shkronja “d” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“d) dhënies së çmimeve kombëtare dhe medaljeve për kontribut të veçantë në ruajtjen, forcimin e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, promovimin e Shqipërisë në botë dhe përkrahjen e interesave të saj. Ato miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 5

Pas nenit 23 shtohet neni 23/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 23/1

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve
për Arbëreshët

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët realizon studime të specializuara për historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh. Krijimi, organizimi, mënyra e funksionimit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.7.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11564, datë 24.7.2020
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.

**DEKRET****Nr. 11564, datë 24.7.2020****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 92/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 16/2018 ‘Për diasporën’”.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

VENDIM**Nr. 570, datë 22.7.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 446, DATË 22.5.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË
PERSONELIT TË POLICISË SË
SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 19, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr. 28, datë 2.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, ‘Për buxhetin e vitit 2020’, të ndryshuar”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 446, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... 11 058 (njëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e tetë) punonjës ...”, zëvendësohen me “... 11 645 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) punonjës ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 571, datë 22.7.2020**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
591, DATË 5.9.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
PERSONALITETEVE TË TJERA TË
LARTA SHTETËRORE TË VENDIT, QË
DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA
GARDA E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “e”, të pikës 1, të vendimit nr. 591, datë 5.9.2007, të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) Kryenegociatorin për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, me trupprojë-shofer, gjithsej 2 nënoficerë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 572, datë 22.7.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 445, DATË 22.5.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS, TË LIMITIT ORGANIK
DHE PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE
KORRESPONDUESE PËR ÇDO GRADË
NË GARDËN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 9366,



datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.445, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 4, shifra “1408” zëvendësohet me shifrën “1435”.

b) Lidhjet nr. 1, nr. 2, dhe nr. 3, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 573, datë 22.7.2020

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE TË SISTEMIT TË KRAHASIMIT DHE VLERËSIMIT TË SIGURT TË IDENTIFIKIMIT PERSONAL (PISCES) DHE SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE ME SISTEMIN TOTAL TË MENAXHIMIT (TIMS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të ligjit nr. 42/2018, “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”, dhe të ligjit nr. 72/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për shkëmbimin e

informacionit për verifikimin e terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin në Ministrinë e Brendshme të sistemit të krahasimit dhe vlerësimit të sigurt të identifikimit personal (PISCES) dhe të shkëmbimit të bazës së të dhënave të këtij sistemi me sistemin total të menaxhimit të informacionit (TIMS).

2. Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave të sistemit “PISCES” dhe ndërveprimin e tij me sistemet e tjera të informacionit, nëpërmjet teknologjisë së shërbimit standard *web-service*.

3. Ministria e Brendshme përcakton politikat e sigurisë për administrimin e pajisjeve dhe të dhënave të këtij sistemi.

4. Sistemi “PISCES” ka për qëllim regjistrimin e hyrje-daljeve në Republikën e Shqipërisë të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, në pikat e kalimit kufitar ku ky sistem do të implementohet, si dhe shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit dhe të kalimit të paligjshëm të kufirit.

5. Dhënësi i informacionit për sistemin “PISCES” është Policia e Shtetit.

6. Sistemi i menaxhimit total të informacionit “TIMS” do të ndërveprojë me sistemin e krahasimit dhe vlerësimit të sigurt të identifikimit personal “PISCES”, si plotësues të njëri-tjetrit, në përputhje me nevojat e Policisë së Shtetit.

7. Importimi i të dhënave historike nga sistemi “TIMS” në sistemin “PISCES” do të bëhet për, të paktën, 5 (pesë) vitet e fundit.

8. Të dhënat që do të importohen nga sistemi “TIMS” në sistemin “PISCES” do të jenë hyrjet dhe daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në pikat e kalimit kufitar, si dhe kategorive INAD/deportiv/refuzuar.

9. Procedurat për funksionimin dhe përdorimin nga Policia e Shtetit të sistemit “PISCES” përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

10. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama



VENDIM
Nr. 574, datë 22.7.2020

**PËR MIRATIMIN E KUADRIT
MAKROEKONOMIK E FISKAL,
TË RISHIKUAR, PËR PERIUDHËN
2021–2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal, të rishikuar, për periudhën 2021–2023, si dhe lidhjen nr. 1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë” dhe lidhjet nr. 2/1 e nr. 2/2, “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**KUADRI MAKROEKONOMIK DHE
FISKAL 2021–2023**

I rishikuar
Korrik, 2020

Tabela e përmbajtjes

Shkurtime

Hyrje

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

2. Politikat fiskale

3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike
Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Lidhja nr. 1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë”

Lidhja nr. 2/1 “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)”

Faqe | 8482

Lidhja nr. 2/2 “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)”

Shkurtime

BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KM	Këshilli i Ministrave
KMF	Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal
LOB	Ligji organik i buxhetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i brendshëm bruto
SPI	Sistemi i planifikimit të integruar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WEO	World Economic Outlook

**KUADRI MAKROEKONOMIK
DHE FISKAL**

2021–2023

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Hyrje

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) për periudhën 2021–2023 është pjesë e sistemit të planifikimit të integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. KMF-ja ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projektton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale, si: balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF-ja shërben si bazë për përcaktimin e taveve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021–2023 në nivel ministrie.

KMF-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar të çdo viti, dhe mund të jetë sërish subjekt rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit, përpara finalizimit të PBA-së dhe të taveve për shpenzimet.

KMF-ja përmban dy komponentë kryesorë: i) parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomik të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vitet e



ardhshme; dhe ii) parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskalë, të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2021–2023 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë sipas buxhetit të konsoliduar. Këta komponentë paraqiten në mënyrë tabelore në fund të këtij dokumenti, përkatësisht, lidhja nr. 1; lidhja nr. 2/1; dhe lidhja nr. 2/2.

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit ka treguar një trend pozitiv zhvillimi që është pasqyruar në një sërë parametrash makro-ekonomikë në vend. Megjithatë ekonomia shqiptare përjetoj dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2020. Në muajin nëntor të vitit 2019, vendi u godit nga një tërmet tepër i fortë që solli dëme në njerëz dhe në ekonomi, ndërsa në muajin mars të vitit 2020 pandemia e COVID-19 u përhap dhe në Shqipëri, masat e ndërmarra ndaj së cilës, impaktuan ndjeshëm aktivitetin ekonomik në vend. Viti 2019 shënoi rritje ekonomike prej 2.2 për qind, krahasuar me rritjen prej 4.1 për qind të një viti më parë, si pasojë e faktorëve të paqëndrueshëm apo të përkohshëm përgjatë vitit, por edhe si pasojë e goditjes nga tërmeti, ku PBB-ja reale u tkurr me 0.2 për qind në terma vjetorë në tremujorin e katërt, pas një rritje prej 4.2 për qind në tremujorin e tretë.



Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, ekonomia globale u përball me përhapjen e pandemisë COVID-19 dhe me masat shtrënguese të ndërmarra nga autoritetet publike për frenimin e përhapjes. Në Shqipëri, qeveria vendosi kufizime të lëvizjes së lirë në muajin mars, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të pandemisë në vend. Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj

tkurrjes ekonomike prej pandemisë për shkak se mbështetet fort nga sektori i turizmit dhe për shkak të marrëdhënieve të saj intensive me disa ekonomi të BE-së të prekura rëndë nga pandemia. Sipas vlerësimit më të fundit nga INSTAT-i për tremujorin e parë të vitit 2020, ekonomia ka pësuar rënie me 2.52 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019.

Sipas optikës së kërkesës agregate, rritja përgjatë vitit 2019 u gjenerua nga konsumi final, si dhe nga kërkesa e brendshme. Në gjysmën e parë të vitit 2020, vlerësohet se të gjithë komponentët e kërkesës agregate duhet të kenë pësuar rënie duke reflektuar kështu tkurje të fortë të rritjes ekonomike. Pasojat e masave shtrënguese për frenimin e përhapjes së pandemisë, kanë sjellë ngadalësim të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, konsumit familjar dhe investimeve në ekonomi, kryesisht atyre private. Te kjo e fundit, një kontribut të konsiderueshëm negativ krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë vjen edhe prej shuarjes së kontributit pozitiv të ardhur nga faza ndërtuese e projektit TAP që tashmë është pothuajse i përfunduar. Gjithsesi së shpejti ky projekt do të jetë operativ dhe partjetër pritet të japë një efekt të konsiderueshëm pozitiv në vijimësi për ekonominë tonë kryesisht nëpërmjet mundësimit të një burimi alternativ dhe të lirë energjie. Megjithatë, vetëm për tremujorin e parë të vitit 2020, konsumi final ka treguar një rritje prej 1.1 për qind, ndërsa investimet totale një kontraktim të fortë dhe për rrjedhojë rritja e kërkesës së brendshme është vlerësuar negativisht. Duke marrë në konsideratë performancën e vitit 2019 dhe pritshmëritë për vitin 2020, i cili pritet të pasqyrojë si efektet e tërmetit që goditi Shqipërinë, dhe pasojat nga pandemia globale, rritja ekonomike për të gjithë vitin 2020 rishikohet në rënie nga parashikimet e mëparshme, në vlerën prej -4.3 për qind.

Konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, u rrit me rreth 3.3 për qind në terma realë vjetorë përgjatë vitit 2019, gjithashtu, dhe konsumi final i popullatës u rrit me të njëjtën vlerë. Ndërkohë vetëm për tremujorin e parë të vitit 2020, konsumi final total dhe ai i popullatës shënuan rënie të ritmit krahasuar me dy tremujorët paraardhës, respektivisht në 1.1 për qind dhe 1.2 për qind.

Formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale)



pati rënie me rreth 3.8 për qind në terma realë vjetorë përgjatë vitit 2019, ndërkohë vetëm për tremujorin e parë të vitit 2020 kjo normë ishte -16.7 për qind. Kjo rënie i atribuohet kryesisht tkurrjes së investimeve në ndërtim, përfshirë projektin TAP, dhe ndikimit që kanë pasur masat shtrënguese kundër përhapjes së pandemisë në ekonomi.

Nga ana tjetër, dinamika e tregut të punës ashtu si dhe përgjatë gjithë vitit, u mbyll me vlera pozitive në fund të vitit 2019. Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT-i, norma e papunësisë (për grup-moshën 15–64 vjeç) ka vijuar trendin e saj rënës që prej T1-2014 ku regjistroi vlerën e saj më të lartë prej 18 për qind, duke zbritur tashmë në nivelin 11.9 për qind në T1-2020, me një rritje prej 0.2 pikë përqindje krahasuar me një tremujor më parë, T4-2019. Ndërkohë, për grup-moshën 15 vjeç e sipër, norma e papunësisë gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 regjistroi nivelin prej 11.4 për qind.

Bazuar në statistikën e bilancit të pagesave të BSH-së, bilanci i pagesave (BP) për vitin 2019, shënoi rënie kundrejt një viti më parë duke arritur vlerën -77.8 milionë euro, nga 371.8 milionë euro më 2018-n. Ndërsa vetëm për tremujorin e parë të 2020-s, bilanci i pagesave regjistroi balancë negative prej -51.2 milionë euro, krahasuar me tremujorin e parë të 2019, ku, gjithashtu, shënonte balancë negative prej -70.8 milionë euro.

Deficiti tregtar u përmirësua gjatë vitit 2019 me rreth 9.5 për qind, si rezultat i një rritje të volumit të eksporteve dhe deficiti i llogarisë korrente u përmirësua me rreth 20 për qind. Në tremujorin e parë të 2020, deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 226 milionë euro. Ecuria e deficitit korrent reflekton ngushtimin e deficitit tregtar në mallra dhe zgjerimin e balancës pozitive të të ardhurave dytësore, të cilat kanë zbutur efektin negativ të rënies së suficitit në shërbime dhe zgjerimit të balancës negative të të ardhurave parësore. Në gamën e eksporteve të shërbimeve, ato që ndikuan më së shumti ishin shërbimet e ndërlidhura kryesisht me aktivitetin e sektorit turistik, të cilat u rritën me rreth 12.2 për qind, duke kontribuar konsiderueshëm në reduktimin e deficitit të llogarisë korrente. Po ashtu, remitancat u rritën me rreth 4.8 për qind, megjithatë kontributi i tyre në përmirësimin e llogarisë korrente ishte disi më marxhinal duke qenë se pesha e tyre është

zvogëluar ndjeshëm përgjatë viteve të fundit.

Llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në vlerën +895 milionë euro gjatë vitit 2019 krahasuar me +1.246 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në tremujorin e parë të 2020, llogaria financiare dhe kapitale u zvogëlua në +235 mln euro, krahasuar me +320 mln euro në tremujorin e parë të 2019-s.

Inflacioni përgjatë vitit 2019 ka shënuar ritme më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Ndërsa nga të dhënat e disponueshme deri në hartimin e këtij materiali, inflacioni mesatar për periudhën janar–qershor të vitit 2020 është 1.8 për qind, pra në rritje krahasuar me vitin paraardhës.

2. Politikë fiskale

Pas një stimuli të lartë, të domosdoshëm dhe njëkohësisht të paevitueshëm gjatë vitit 2020 me qëllim amortizmin e goditjeve negative (tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale për periudhën afatmesme 2021–2023 do të riorientohet sërish drejt konsolidimit fiskal ndërkohë që siguron një nivel optimal investimesh prej mbi 4.5 për qind të PBB-së. Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Objektivat e politikës fiskale në KMF 2021–2023 janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të ligjit organik të buxhetit (shih kuadratin në faqen 7).

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 4.2 për qind të PBB-së-së për 2021, nga 8.4 për qind i programuar për vitin 2020; nivel prej 1.7 për qind të PBB-së në 2022; dhe 1.3 për qind në vitin 2023. Njëkohësisht, si rrjedhojë e dy goditjeve të njëpasnjëshme fillimisht nga tërmeti dhe më pas shumë më fort nga pandemia COVID-19, balanca primare pritet të shënojë vlera negative edhe për vitin 2021, në rreth 1.7 për qind, ndonëse me përmirësim të fortë nga niveli negativ prej 5.9 për qind që pritet për 2020, ndërkohë që targetohet në vijimësi rikthimi në vlera pozitive që në vitin 2022 me 1 për qind dhe 1.6 për qind në vitin 2023.



Lidhur me balancën primare, i cili është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, së fundmi (korrik 2020) u shtua edhe një rregull i ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE-së dhe me parimet kryesore të *aquis* të BE-së, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë që duke filluar që prej vitit buxhetor 2023 e në vijim balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektore vijimësisht rënëse të borxhit publik, pra, duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fundament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mbarë-vajtjes së ekonomisë së vendit. Më konkretisht, duke marrë të mirëqena supozimet dhe projeksionet e tjera të këtij kuadri aktual, respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objektiv (rregulli fiskal) të parametrit të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik në rreth 65 për qind të PBB-së deri në vitin 2025 nga rreth 80 për qind që pritet të rezultojë më 2020-n.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 57/2016, KMF 2021–2023 i rishikuar materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj produktit të brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të produktit të brendshëm bruto.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2021–2023 i rishikuar *targeton* çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB-së më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook)¹, të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-it, kuadri 2021–2023 i rishikuar *bazohet* në projeksionet e mëposhtme të PBB-së nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve më të fundit të FMN-së, në këtë rast të publikuara në muajin prill 2020 në raportin “Albania – Request for purchase under the rapid financing instrument – Press release; Staff report; and Statement by the Executive director for Albania”². Duke qenë se në raportin “World Economic Outlook” publikuar në muajin prill 2020 nuk janë publikuar të dhënat e domosdoshme krahasimore të PBB-së nominale në lekë, ndërkohë që janë publikuar në raportin e veçantë të sipërpërmendur posaçërisht për Shqipërinë, brenda të njëjtit muaj, atëherë krahasimi i parashikimeve të PBB-së nominale të FMN-së dhe të MFE-së, është kryer me të dhënat e këtij të fundit.

Parashikimet e PBB nominale të FMN dhe MFE	(në miliardë Lekë)						
	2017	2018	2019	2020 Fore.	2021 Fore.	2022 Fore.	2023 Fore.
FMN	1,551	1,636	1,678	1,635	1,814	1,995	2,125
MFE	1,551	1,636	1,678	1,580	1,723	1,842	1,970
Diferenca FMN - MFE (Diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e vogël se zero)	0.6	0.3	0.0	55.0	91.0	153.0	155.0

¹ Linku për raportin “WEO” –

<https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2020/04/14/weo-april-2020>

² Linku për raportin “Albania – Request for purchase under the rapid financing instrument – Press release; Staff report; and Statement by the Executive director for Albania” –

<https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2020/04/17/Albania-Request-for-Purchase-under-the-Rapid-Financing-Instrument-Press-Release-Staff-Report-49347>



3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-it, kuadri 2021–2023 i rishikuar përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontingjencë për luhatjet e normave të interesit etj.” një kontingjencë prej mbi 0.7 për qind e shpenzimeve totale.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 4/1 të ligjit organik të buxhetit nr. 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-it, kuadri 2021–2023 i rishikuar **nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.**

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB-it, deficitin e targetuar në kuadrin 2021–2023 të rishikuar është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara. Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 2.8 për qind të PBB-së në çdo vit të programuar.

Metodologjia e parashikimeve makro-ekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomikë afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomike-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agentëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej

institucioneve, si: INSTAT, BSH, MFE, FMN, BB, Eurostat etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme, dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelorë të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tre viteve në vijim nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies të Bashkimit Evropian, janë:

- Synimi i një trajektore rënëse të borxhit publik duke targetuar si objektiv operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit mundësisht që prej vitit 2022, por domosdoshmërisht prej vitit buxhetor 2023 dhe në vijim. Që prej korrikut 2020 ky objektiv tashmë është sanksionuar edhe në LOB nëpërmjet përfshirjes së një rregulli të ri fiskal.

- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht mbi nivelin 4.5 për qind të PBB-së mesatarisht çdo vit.

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektiv themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3 për qind dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizmin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare.

- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore, dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysHEME të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këta objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Pas recensionit të fortë në vitin 2020, aktualisht i parashikuar në -4.3 për qind, ekonomia pritet të

rekuperohet në vitin 2021 dhe të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në 5.9 për qind në vitin 2021 dhe parashikohet të vijojë të qëndrojë afër nivelit prej 4 për qind përgjatë periudhës afatmesme në vijim. Më specifikisht rritja ekonomike parashikohet në 3.8 dhe 3.9 për qind respektivisht për vitet 2022 dhe 2023.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritët të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport–import) pritët të ketë pothuajse një efekt neutral. Konsumi privat pritët të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritët të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredi-marrje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar në periudhën afatmesme, pas kapërcimit të efektit negativ nga goditja e pandemisë.

Ndërsa rritja graduale e investimeve pritët të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përsheptimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe përmirësimi i kushteve financiare dhe lehtësimit të standardeve të huadhënies priten të jenë një faktor i rëndësishëm


incentivues i investimeve private në afatin e mesëm.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2021–2023) parashikohet të rritet në terma realë me mesatarisht rreth 3.8 për qind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 3.4 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së-së. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma realë mbi nivelin 3.1 për qind në vitet 2021–2023, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 0.7 pikë përqindje në vit.

Kërkesa e jashtme neto pritët të ketë efekt pothuajse neutral në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten gjithashtu të rikthejnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe do të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2021–2023, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 13.3 për qind në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 3.4 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 7.5 për qind në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB-së me rreth 3 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv, pothuajse neutral, në rritjen totale të PBB-së me mesatarisht rreth 0.4 pikë përqindje në vit.

Grafik. Rritja reale (majtas, në për qind) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.), sipas komponentëve të kërkesës agregate




Burimi: INSTAT, MFE



Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, politika buxhetore e qeverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike në mbi 4.5 për qind të PBB-së në vitet 2021-2023 do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Në të njëjtën kohë, vijimi i politikës monetare akomoduese parashikuar në periudhën afatmesme, duke marrë parasysh presionet e ulëta inflacioniste, do të mbështesë konsumin privat dhe investimet.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritët të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimul në sektorin privat, fundamente mjaft të rëndësishme këto për sigurimin e një rritje të lartë e të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen dhe për këtë arsye efekti shtrëngues i konsolidimit fiskal pritët të kompensohet.

Grafik. Rritja reale (majtas, në për qind) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.), sipas komponentëve të ofertës agregate




Burimi: INSTAT, MFE

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritët që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht, bujqësia pritët të rritet mesatarisht me rreth 1.3 për qind në vit në terma realë përgjatë periudhës 2021–2023, me një kontribut mesatar vjetor në rritjen ekonomike prej rreth 0.3 pikë përqindje; industria me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.2 për qind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.6 pikë përqindje; ndërtimi me rritje mesatare vjetore prej rreth 3.6 për qind dhe kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.3 pikë përqindje; shërbimet me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.7 për qind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 2.7 pikë përqindje.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritët të rritet me një mesatare prej rreth 2.4 për qind në vit gjatë viteve 2021–2023. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritët të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht pritët që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Pavarësisht zgjerimit të pritsëm të punësimit në afatin e mesëm, sërish produktiviteti i përgjithshëm i punës pritët të ketë një përmirësim të lehtë gjatë kësaj periudhe.



Grafik. Punësimi (në të majtë, rritja vjetore në për qind) dhe norma e papunësisë (në të djathtë, në për qind)




Burimi: INSTAT, MFE

Presionet inflacioniste parashikohet të forcohen në periudhën afatmesme. Inflacioni pritet të rritet gradualisht dhe të rikthehet në objektivin e politikës monetare, brenda vitit 2023. Presionet e brendshme inflacioniste priten të përshpejtohen si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe investimeve, të cilat do të mbështesin një ritëm më të shpejtë të rritjes ekonomike. Për më tepër, parashikimi për forcimin e kërkesës agregate dhe inflacionit në mjedisin ndërkombëtar pritet të përçojnë një efekt inflacionist disi më të rritur në ekonominë shqiptare për periudhën afatmesme në vijim.

Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur VKM-së

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, reformave fiskale të ndërmarra, efekteve të pritshme të përmirësimit administrativ, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vitet në vijim (2021–2023) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 8.7 për qind në çdo vit, më specifikisht 13.2 për qind për vitin 2021, 5.9 për qind për 2022 dhe 6.9 për qind për 2023. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 9.5 për qind.

Grafik. Të ardhurat (majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind të PBB-së)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tre vitet në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2021–2023 pritet të jenë mesatarisht në rreth 537 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 29.1 për qind e



PBB-së. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 5 për qind të PBB-së në çdo vit. Këto konsiderohen nivele optimale për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Grafik. Shpenzimet (majtas në miliardë lekë, djathtas në për qind të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në lidhjet nr. 2/1 dhe nr. 2/2, bashkëngjitur VKM-së, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB-në.

Lidhja nr. 1. Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
					Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.87	2.87	2.86	2.86	2.85	2.84	2.84
Inflacioni (mesatar)	%	2.0	2.0	1.4	2.1	2.4	2.8	3.0
Deflatori i PBB	%	1.5	1.4	0.4	-1.6	2.9	3.0	3.0
Kursi i këmbinit (mesatar)	Lek / USD	119.1	108.0	109.9	109.9	109.9	109.9	109.9
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP)	Lek / USD	41.8	42.6	42.6	42.6	42.6	42.6	42.6
Rritja reale e PBB	%	3.8	4.1	2.2	-4.3	5.9	3.8	3.9
PBB	Lek miliardë	1,550.6	1,635.7	1,678.4	1,581.0	1,723.1	1,842.1	1,970.1
PBB	USD miliardë	13.0	15.1	15.3	14.4	15.7	16.8	17.9
PBB	Euro miliardë	11.6	12.8	13.6	12.9	14.0	15.0	16.0
PBB për banor	Lek mijë	539.6	570.7	586.4	553.4	604.5	647.8	694.8
PBB për banor	USD	4,531.0	5,284.4	5,337.8	5,037.9	5,502.9	5,897.5	6,324.8
PBB për banor	Euro	4,022.7	4,472.6	4,766.6	4,498.8	4,914.1	5,266.4	5,648.0
PBB për banor	USD-PPP	12,924.8	13,403.6	13,772.6	12,998.6	14,198.5	15,216.5	16,319.1
PBB për banor	Euro-PPP	9,702.9	10,240.5	10,522.4	9,931.1	10,847.9	11,625.6	12,468.0
Norma e papunësisë (15-64 vjeç)	%	14.1	13.0	12.9	13.8	10.9	9.4	9.0
Të ardhurat totale	Lek miliardë	430.4	449.9	460.3	446.6	505.4	535.3	572.2
Shpenzimet totale	Lek miliardë	461.4	476.1	491.9	579.5	578.0	566.5	596.9
Bilanci i përgjithshëm	Lek miliardë	-31.0	-26.2	-31.5	-133.0	-72.6	-31.3	-24.7
Bilanci primar	Lek miliardë	0.9	10.3	3.6	-92.7	-28.5	19.3	32.0
Bilanci korrent	Lek miliardë	46.7	52.2	43.4	-11.1	39.6	52.1	64.1
Huamarrja e Brendshme Neto	Lek miliardë	16.3	19.6	17.8	49.9	49.9	43.0	10.0
Të Ardhura nga Privatizimet	Lek miliardë	0.4	0.1	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0
Huamarrja e Huaj Netë	Lek miliardë	28.9	33.0	-7.7	82.6	8.4	-11.3	37.5
Huamarrje totale netë	Lek miliardë	45.2	52.6	10.2	132.5	58.3	31.7	47.5
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Netë)	Lek miliardë	1,066.3	1,057.8	1,096.5	1,256.9	1,316.0	1,345.9	1,372.1
Borxhi Publik (Bruto)	Lek miliardë	1,088.2	1,107.3	1,112.6	1,272.6	1,317.4	1,347.7	1,396.8
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	Lek miliardë	1,037.5	1,061.9	1,070.2	1,202.7	1,261.0	1,292.8	1,340.3
Borxhi publik jashtë treguesve fiskale	Lek miliardë	50.7	45.4	42.4	69.9	56.4	55.0	56.5
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-7.5	-6.8	-7.6	-8.9	-7.5	-7.5	-7.4
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-15.1	-13.7	-13.7	-15.5	-13.6	-13.2	-12.7
Mallra	% të PBB	-24.4	-22.4	-23.0	-21.1	-21.1	-20.4	-20.1
Eksporte	% të PBB	6.9	7.7	6.6	6.0	6.6	7.0	7.2
Importe	% të PBB	-31.3	-30.1	-29.7	-27.1	-27.7	-27.4	-27.2
Bilanci i Llogarisë Kapitale dhe Financiare	% të PBB	10.7	9.7	6.6	9.1	7.0	7.5	9.4
Investimet e Huaja Direkte (netë)	% të PBB	8.6	8.0	7.6	6.6	6.8	7.1	7.2
Bilanci i pagesave	% të PBB	1.6	2.9	-0.6	0.7	0.0	0.4	2.4
Rezervat valutore	Euro milionë	2,995.9	3,399.0	3,359.6	3,446.1	3,445.9	3,511.8	3,898.2
Në muaj importi mall. e shërb.	Muaj	6.7	7.0	6.5	8.2	7.3	6.9	7.2

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë



Lidhja nr. 2/1. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)

Nr.	E M E R T I M I	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
					AN	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	430,397	449,909	460,349	446,570	505,379	535,275	572,210
I.	Ndihmat	11,085	8,164	10,609	18,000	17,353	13,994	14,958
	nga të cilat: mbështetje buxhetore nga KE	2,738	2,251		2,500	6,353	2,994	2,958
	nga të cilat: donacione për ri-ndërtimin			1,798	3,000			
	nga të cilat: për projekte të destinuara				12,500	11,000	11,000	12,000
II.	Të ardhura tatimore	398,629	419,333	426,271	408,045	466,426	498,631	534,353
II.1	Nga tatimet dhe doganat	293,386	304,318	304,758	290,000	335,000	358,000	384,000
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	18,447	21,863	23,102	23,045	25,426	26,632	28,353
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	86,795	93,153	98,411	95,000	106,000	114,000	122,000
III.	Të ardhura jo-tatimore	20,683	22,412	23,469	20,525	21,600	22,650	22,900
	TOTALI I SHPENZIMEVE	461,410	476,147	491,897	579,535	578,008	566,546	596,899
I.	Shpenzime Korrente	382,287	397,345	416,852	441,498	462,816	481,493	505,652
6. Njësia e vetëqeverisjes vendore ose subjekti i ngarkuar me administrimin e strehëve të përkohshme siguron cilësinë e administrimit, duke përcaktuar kushtet minimale që duhet të plotësojë:

a) mirëmbajtja e strehëve të përkohshme, në përputhje me planin përkatës të miratuar për këtë qëllim, ku përfshihen:

i. kryerja e rinovimeve dhe periodiciteti i tyre;

ii. afati kohor për ndreqjen e defekteve;



iii. vazhdimësia dhe intensiteti i pastrimit dhe dezinfektimit;

b) Kujdesi social dhe shëndetësor, në përputhje me planin përkatës të miratuar për këtë qëllim, ku përfshihen:

i. lloji i shërbimeve shëndetësore që duhet të kryhen;

ii. numri dhe lloji i trajnimeve dhe i kurseve të aftësisimit profesional që duhet të zhvillohen;

iii. lloji dhe frekuenca e aktiviteteve të tjera.

7. Në rastet e administrimit dhe/ose mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme nga subjekte të tjera, parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi, njësia e vetëqeverisjes vendore lidh kontratë me to. Kontrata parashikon:

a) objektin e bashkëpunimit;

b) tërësinë e shërbimit/ve që ofrohen;

c) afatin e kryerjes së shërbimit;

ç) të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga ky vendim dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me të;

d) kushte ndëshkuese për subjektin që nuk respekton rregullat e administrimit të përmbushjes së shërbimit të kontraktuar;

dh) zgjidhjen e kontratës para afatit në rast të shkeljes së rregullave të administrimit dhe/ose mirëmbajtjes, si dhe të mospërmbushjes së detyrimeve thelbësore, të parashikuara nga palët, duke përfshirë edhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga zgjidhja e parakohshme e saj.

8. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore inspekton çdo muaj, si dhe në mënyrë të befasishme, strehët e përkohshme kur është nënshkruar kontratë me subjekte private, sipas pikës 2, të këtij vendimi. Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore harton një raport për zbatimin e kushteve të administrimit dhe problematikave që ka ndeshur si dhe merr masat përkatëse në rast mosrespektimi të rregullave përkatëse.

9. Subjekti privat i kontraktuar për administrimin e strehës së përkohshme raporton çdo muaj pranë strukturës përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Kjo strukturë, në çdo rast, i raporton kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për zbatimin e kushteve të administrimit dhe problematikave që ka ndeshur. Në fund të vitit, subjekti administrues harton një raport përmbledhës për aktivitetin e mirëmbajtjes

dhe kujdesit social e shëndetësor të strehës së përkohshme.

10. Për administrimin e strehëve të përkohshme, njësia e vetëqeverisjes vendore ose subjekti që administron strehët e përkohshme mbështetet nga:

a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale për ofrimin e shërbimeve sociale, sipas nevojave të grupeve sociale të akomoduar në strehët e përkohshme, të identifikuar nga punonjësi social, pranë strukturave të posaçme të shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) ministria përgjegjëse për shëndetësinë për ofrimin e shërbimeve bazë shëndetësore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) ministria përgjegjëse për arsimin për ofrimin e shërbimeve arsimore të nevojshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) ministria përgjegjëse për strehimin, përmes mbështetjes financiare për sigurimin dhe, kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk siguron të ardhura të mjaftueshme, edhe për mirëmbajtjen e administrimin e strehëve të përkohshme nëpërmjet fondeve publike.

11. Njësia e vetëqeverisjes vendore informon menjëherë me rastin e ngritjes së një strehe të përkohshme ministritë e përmendura në pikën 10, të këtij vendimi. Këto të fundit ngarkojnë strukturat përkatëse në varësi të tyre për identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

12. Për individët/familjet që jetojnë në një strehë të përkohshme njësia e vetëqeverisjes vendore mban një dosje personale, të cilën e përditëson sipas rastit. Njësia e vetëqeverisjes vendore garanton ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të dosjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale.

13. Strehët e përkohshme janë funksionale gjatë gjithë ditës (24 orë/24) dhe gjatë gjithë javës (7/7 ditë). Individët që jetojnë në një strehë të përkohshme kanë të drejtë të paraqesin ankesat pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore në rast se kushtet e parashikuara në këtë vendim nuk garantohen. Kryetari ngre menjëherë grupe pune për verifikimin e ankesave dhe merr masat e nevojshme për përmirësimin e kushteve në përputhje me këtë vendim.



14. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, ministria përgjegjëse për arsimin, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për çështjet sociale, policia e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe Policia e Shtetit, institucionet e ofrimit të shërbimeve publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 580, datë 22.7.2020

**PËR PROCEDURAT E BLERJES NGA
TREGU, TË VLERËSIMIT E TË SHITJES,
SI DHE KRITERET E PËRCAKTIMIT TË
ÇMIMIT TË SHITJES SË TRUALLIT,
FAMILJEVE QË PËRFITOJNË BANESA
ME KOSTO TË ULËT, NË VARËSI TË
NIVELIT TË TË ARDHURAVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 45, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Blerja e banesave me kosto të ulët në tregun e lirë mund të kryhet nga:

a) vetë individët/familjet në tregun e lirë, të cilët më pas financohen për të siguruar shlyerjen e çmimit të blerjes së banesave me kosto të ulët, nëpërmjet përfitimit nga programi i subvencionimit të kredisë;

b) njësitë e vetëqeverisjes vendore ose Enti Kombëtar i Banesave, me pjesëmarrjen e përfituesve të programit të banesave me kosto të ulët, kur çmimi i tyre në treg është më i ulët se kostoja e ndërtimit të banesave nga shteti dhe/ose njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Banesat që blihen për t’iu shtuar fondit të banesave sociale me qira, duhet të plotësojnë normat dhe kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi që përcakton kushtet, normat dhe

standardet e banesave me kosto të ulët në programet përkatëse të strehimit.

3. Me disponimin e fondeve për blerjen e banesave me kosto të ulët në treg, subjekti, që zbaton programin e banesave me kosto të ulët, përcakton numrin dhe strukturën e banesave që mund të blihen për llogari të familjeve/individëve përfitues nga ky program.

4. Njësia përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore ose Enti Kombëtar i Banesave, përpara fillimit të procedurës me shpalljen e ftesës publike për marrjen e ofertave për shitblerjen e banesave me kosto të ulët, kryen këto veprime:

a) Formulon shpalljen e ftesës publike për marrjen e ofertave;

b) Përcakton dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e ofertave, duke listuar kërkesat dhe kriteret ligjore e teknike.

5. Shpallja e ftesës publike për marrjen e ofertave për shitblerjen e banesave me kosto të ulët bëhet përmes publikimit për tri ditë rresht në median e shkruar dhe vizive me shikueshmërinë ose tirazhin më të lartë të botimit, në faqen e internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe Entit Kombëtar të Banesave, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare vendore dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në ambiente me frekuentim të lartë, si postat, vendet e pagesave të energjisë elektrike, të marrjes së pensionit etj. Njoftimi përmban:

a) çmimin tavan për blerjen e banesës, i cili nuk duhet të jetë më i lartë se kostoja e ndërtimit në atë njësi të vetëqeverisjes vendore, e përcaktuar sipas çmimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) numrin e apartamenteve që do të blihen;

c) strukturat e apartamenteve dhe sipërfaqet e tyre, sipas normave përkatëse të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) vendndodhjen e dëshiruar;

d) kushtet dhe standardet që duhet të plotësojë banesa në respektim të kushteve e të standardeve të banesave sociale, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Afati, brenda të cilit priten të depozitohen ofertat për banesat me kosto të ulët që mund të blihen nga tregu i lirë, është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë duke filluar nga e nesërmja pas ditës së tretë të



publikimit të ofertave në median e shkruar dhe atë vizive.

7. Me shpalljen e njoftimit, me urdhër të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të titullarit të Entit Kombëtar të Banesave ngrihet komisioni i shqyrtimit të ofertave, i cili përbëhet nga tre veta, një nënkryetar i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose një drejtor i Entit Kombëtar të Banesave në rolin e kryetarit të komisionit, një ekonomist dhe një inxhinier ndërtimi ose arkitekt në rolin e anëtarit të caktuar përkatësisht nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose drejtori i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave. Anëtarë të komisionit caktohen persona të cilët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

8. Ofertat e depozituara duhet të përmbajnë:

a) Informacionin sipas formatit në shtojcën A, që i bashkëlidhet këtij vendimi, që përmban:

i. adresën e objektit/eve ku ndodhet apartamenti/et;

ii. vitin e ndërtimit të objektit;

iii. katin në të cilin ndodhet apartamenti/et;

iv. orientimin;

v. sipërfaqen e apartamentit/eve dhe të mjediseve të përbashkëta,

vi. pranimë e problemeve teknike, të tilla si: funksionimi i rrjetit të ujësjellësit dhe shkarkimit të ujërave të zeza, pranimë e lagështirës e të tjera të ngjashme me to;

vii. çmimin e ofruar për shitje, të shprehur në lekë, për apartament.

b) Planimetrinë e apartamentit/eve;

c) Certifikatën e pronësisë;

ç) Vërtetim, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për të vërtetuar se prona nuk është e rënduar me ndonjë barrë.

9. Subjektet e përzgjedhura mund të angazhohen vetë për gjetjen e banesës me kosto të ulët, për të siguruar sa më shumë përputhjen e kostos më të ulët për ta dhe vendndodhjen e preferuar prej tyre.

10. Me mbarimin e afatit të parashikuar në pikën 6, të këtij vendimi, komisioni i vlerësimit të ofertave hap ofertat ekonomike në prani të ofertuesve dhe të subjekteve të përzgjedhura për t'u trajtuar dhe bën renditjen e subjekteve. Me hapjen e ofertave, komisioni i vlerësimit të ofertave ushtron këto detyra:

a) vlerëson ofertat e depozituara, çmimet përkatëse për çdo banesë me kosto të ulët të ofruar për blerje, si dhe nga pikëpamja teknike nëse oferta është në përputhje me normat, kushtet dhe standardet e kërkuara, duke shkualifikuar çdo ofertë që dukshëm, bazuar në dokumentet e depozituara, nuk plotëson kushtet e përcaktuara në ftesën për ofertë. Kur konstatohen mangësi në dokumentacionin e nevojshëm të ofertave, i kërkohej ofertuesve t'i plotësojnë ato brenda 7 (shtatë) ditëve;

b) përzgjedh ofertën/ofertat me vlerën më të ulët të banesave, ndërmjet banesave që plotësojnë kushtet, normat dhe standardet në fuqi;

c) kryen, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hapja e ofertave, këqyrjen e banesave me kosto të ulët të ofruara për blerje, të cilat inspektohen nga inspektorë të higjienës dhe inxhinierë civilë për të parë nëse plotësojnë kushtet dhe standardet e përcaktuara për banesat sociale që blihen në treg, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave dhe plotësojnë një formular për rezultatet e inspektimit, sipas modelit të parashikuar në shtojcën B, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ç) njofton me shkrim subjektin/et e përzgjedhur/a për t'u blerë banesën me kosto të ulët;

d) shpall listën e subjekteve nga të cilat do të bëhet blerja e banesave me kosto të ulët në faqen e internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të Entit Kombëtar të Banesave.

11. Subjekti/et e vlerësuar/a për blerjen e banesave me kosto të ulët në treg të lirë njoftohet/n me shkrim. Njoftimi përmban:

a) emrin, adresën e subjektit;

b) identifikimin e banesës, vendndodhjen, parcelën, sipërfaqen;

c) çmimin për apartament dhe vlerën e kontratës;

ç) ftesën për të nënshkruar kontratën.

12. Në çmimin e shitjes së banesës me kosto të ulët që është blerë në treg përfshihen, si më poshtë vijon:

a) vlera e apartamentit të blerë sipas kontratës së shitblerjes;

b) shpenzimet noteriale, ato të regjistrimit të pronës dhe pagesa e taksave dhe e tatimeve, sipas rastit;

c) shpenzime administrative, të cilat, në rastin e Entit Kombëtar të Banesave janë 4% e vlerës së



apartamentit të blerë, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, ndërsa në rastin e njësisë të vetëqeverisjes vendore miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Shpenzimet administrative mbulojnë kostot e punës së kryer nga personeli i subjektit që zbaton programin për blerjen dhe shitjen e banesës me kosto të ulët.

13. Kur banesat me kosto të ulët janë siguruar përmes ndërtimit, në përlogaritjen e çmimit të shitjes së tyre përfshihen, si më poshtë vijon:

a) kostoja e ndërtimit të banesës ku përfshihen vlera e investuar për ndërtimin e saj, kostot për mbikëqyrjen dhe për kolaudimin, kostot e projektit, kostot e marrjes së lejeve përkatëse për ndërtim;

b) çmimi i truallit, i cili përcaktohet sipas vendimit të qeverisë për efekt kompensimi të pronave;

c) shpenzimet e regjistrimit për kalimin e së drejtës së pronësisë në favor të përfituesit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, shpenzimet materiale dhe çdo shpenzim i kryer për pagesën e taksave dhe tatimeve;

ç) shpenzimet administrative, të cilat, në rastin e objekteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave llogariten 4% e kostos së ndërtimit, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike.

14. Në rastin kur banesat me kosto të ulët janë siguruar nëpërmjet ndërtimeve të reja me financime nga të ardhurat e veta të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose nga buxheti i shtetit, në çmimin e shitjes së banesës me kosto të ulët nuk përfshihen kostot e investimit për lidhjen e banesës me infrastrukturën ekzistuese, për furnizimin e banesës me rrjetin kryesor të ujësjellësit, të kanalizimeve, të furnizimit me energji e shërbim telefonie.

15. Trualli funksional i banesës shitet si pjesë përbërëse dhe e pandarë me banesën. Me truall funksional, kur nuk është specifikuar ndryshe në lejen e ndërtimit dhe/ose në kontratën e shitblerjes së banesës me kosto të ulët, kuptohet sipërfaqja e truallit nën objekt, plus 1 metër trotuar rreth objektit.

16. Me qëllim arritjen e nivelit të kësteve të përballueshme, sipas përcaktimeve të nenit 3, të ligjit nr. 22/2018, për familjet me të ardhura të ulëta e shumë të ulëta, sipas përcaktimeve të shkronjave “b” e “c”, të pikës 45, të nenit 2, të ligjit, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kuadrin ligjor për sistemin e taksave vendore, mund të vendosë uljen ose përjashtimin e

kategorive të caktuara nga pagesa e çmimit të truallit, pronë shtetërore, mbi të cilin është ndërtuar banesa me kosto të ulët dhe/ose e taksave e tarifave që janë kompetencë e këshillit të vetëqeverisjes vendore.

17. Përjashtimisht, kur banesat me kosto të ulët janë siguruar nëpërmjet ndërtimeve të reja me financime nga të ardhurat e veta të Entit Kombëtar të Banesave dhe kur investimet për zërat e përmendur në pikën 13, të këtij vendimi, janë realizuar nga të ardhurat e veta të EKB-së, këto kosto përfshihen në çmimin e shitjes, nëse nuk janë marrë përsipër nga njësia e vetëqeverisjes vendore në marrëveshjen që nënshkruhet ndërmjet tyre.

18. Njësia e vetëqeverisjes vendore, për transparencë, fillimisht përcakton koston reale që rezulton sipas pikave 12 dhe 13, të këtij vendimi, dhe krahas saj vendos çmimin pas uljeve që janë bërë me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ulja e çmimit të shitjes së truallit është individuale për çdo familje, në përputhje me nivelin e të ardhurave dhe aftësinë për të përballuar. Në rastet kur familja/individit nuk përballon dot kostot për blerjen e një banese me kosto të ulët edhe pas uljeve, sipas pikës 16, të këtij vendimi, atëherë ajo kalon në një program tjetër strehimi.

19. Shitja e banesës me kosto të ulët mund të bëhet në format e mëposhtme:

a) me shitje me pagesë të menjëhershme nga blerësi, nëse ka një marrëveshje kreditimi të lehtësuar me bankat e nivelit të dytë, interesat e të cilave subvencionohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore ose buxheti i shtetit;

b) me shlyerje ndaj njësisë së vetëqeverisjes vendore ose Entit Kombëtar të Banesave, me këste të përballueshme, sipas përcaktimeve në nenin 3, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, dhe me interes jo më të lartë se 3%. Kthimi i investimit në këtë rast sigurohet nëpërmjet vendosjes së barrës hipotekore që vihet mbi banesën deri në shlyerjen e plotë të vlerës kontraktuale.

20. Kalimi i pronësisë bëhet me kontratë shitjeje, të lidhur me akt noterial në formën e shitjes me rezervë pronësie, sipas dispozitave të Kodit Civil.

21. Kontrata për shitblerjen e banesave me kosto të ulët i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin e kalimit të së drejtës së pronësisë me rezervë pronësie në favor të



përfituesit. Pronësia mbi banesën me kosto të ulët i kalon familjes/individit blerës, kur blerja është kryer prej saj/tij, pas shyerjes së kështit të fundit të çmimit të shitjes.

22. Verifikimi i nivelit të të ardhurave bëhet në përputhje me vendimin nr.384, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

23. Nëse gjatë periudhës së shlyerjes së vlerës së banesës me kosto të ulët familja, për shkaqe ekonomike, nuk mund të vazhdojë më pagesën e kësteve mujore, njofton menjëherë njësinë e vetëqeverisjes vendore, Entin Kombëtar të Banesave dhe/ose institucionin financiar me të cilin është kontraktuar marrja e kredisë për blerjen e banesës. Në rastin kur kontrata për shlyerjen e vlerës së banesës është lidhur ndërmjet përfituesit dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, banesa mund

të kalojë në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe familja kalon me kontratë qiraje sociale me njësinë e vetëqeverisjes vendore. Në rastin kur familja/individit ka marrë një kredi nga një bankë e nivelit të dytë, me të cilën ka një marrëveshje për subvencionimin e interesave nga njësia e vetëqeverisjes vendore ose buxheti i shtetit, veprohet sipas parashikimeve të vendimit nr.453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”.

24. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, Enti Kombëtar i Banesave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



SHTOJCË A

FORMULARI I OFERTËS

Emër/atësia/mbiemër _____ nr. ID _____,

Adresa: _____; numër telefoni: _____; adresë *email*-i: _____,**OFROJ:**

_____ (numër apartamente), të cilat ndodhen në objektin (objektet) e banimit me të dhëna si më poshtë:

Objekti 1

Adresa: _____ (qyteti) _____, bashkia _____

Viti i ndërtimit _____

Është i pajisur me ashensor: PO JO

☐
☐

Bashkëlidhur:

- a) certifikata/t e pronësisë;
 b) vërtetim, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që prona nuk është e rënduar me ndonjë barrë;
 c) planimetrinë (planimetritë) e apartamentit.

Apartamenti	Sipërfaqja ^{a3}	Përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpronësi ⁴	Struktura ⁵	Kati ⁶	Gjendja e apartamentit ⁷	Çmimi i ofruar ⁸	Komente/sqarime
1							
2							
3							

³ Sipërfaqja e apartamentit siç jepet në certifikatën e pronësisë.⁴ Pjesa e pronësisë së përbashkët që i takon apartamentit siç jepet në certifikatën e pronësisë.⁵ Të shënohet: G – për garsoniere; 1+1 për ap. me një dhomë gjumi dhe një ndenje; 2+1 për dy dhoma gjumi e një ndenje, e kështu me radhë.⁶ Numërimi i katit të fillojë nga 0, ku me 0 shënohet kati i hyrjes në objekt.⁷ Të jepet informacion mbi probleme të mundshme me lagështinë e mureve, tarracës, dyshemesë së katit përdhe, banjës, rrjedhje tubacioni uji etj..**Vini re! Prania e problemeve teknike nuk përbën kusht përjashtimor.**⁸ Çmimi jepet në formatin lekë për apartament.



SHTOJCË B

FORMULAR TIP INSPEKTIMI

Komisioni i inspektimit, sipas vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore për blerjen e banesave me kosto të ulët në treg, i përbërë nga:

1. _____, specialist inxhinier ndërtimi/arkitekt,
 2. _____, specialist hidro/sanitar,
 3. _____, specialist në fushën e higjienës/shëndetësisë
- Inspektoi apartamentin e z./znj. _____, me adresë: qyteti _____, lagjja _____, rr. _____, pallati nr. _____, hyrja nr. _____.

Gjatë inspektimit në objekt u verifikua gjendja:

1. Në përputhshmëri me, normat dhe standardet në fuqi për banesat me kosto të ulët
2. Në përputhshmëri të pjesshme
3. Në papërputhshmëri

☐
☐
☐

Veçanërisht, është verifikuar gjendja fizike, e cila rezultoi si më poshtë:

1. Gjendja e përgjithshme e ndërtimit

1.1 Sipërfaqja e apartamentit sipas dokumentit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës _____m²

1.2 Zbërthimi i sipërfaqeve të ambienteve të banimit

- a) dhomë dite _____ m²
- b) dhomë gjumi (1) _____ m²
- c) dhomë gjumi (2) _____ m²
- d) dhomë gjumi (3) _____ m²
- e) aneks gatimi _____ m²
- f) banjë _____ m²
- g) korridor _____ m²
- h) depo _____ m²
- i) ambiente të përbashkëta _____ m²

2. Gjendja fizike e apartamentit:

2.1 Muratura mbajtëse: Po Jo

a) Janë bërë ndërhyrje me projekt që nuk prishin konstruksionin mbajtës: ☐ ☐

b) Janë bërë ndërhyrje pa projekt, që mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e objektit: ☐ ☐

2.2 Muratura ndarëse:

a) Janë bërë ndryshime të muraturës ndarëse: ☐ ☐

**2.3 Suvatimi i mureve:**

- a) Suvatimi është në gjendje të mirë: ☐☐
b) Suvatimi ka nevojë për riparime në masën _____ m².

2.4 Shtresat:

- a. Shtresat janë në gjendje të mirë: ☐☐
b. Shtresat janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për riparime në masën _____ m².

2.5 Veshje murature banja/ aneks me materiale të padepërtueshme:

- a) Veshjet janë në gjendje të mirë: ☐☐
b) Veshjet janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për riparime në masën _____ m².

2.6 Dyer dhe dritare

- a) Dyert janë në gjendje të mirë: ☐☐
b) Dritaret janë në gjendje të mirë: ☐☐
c) Dyert janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për t'u ndërruar _____ copë.
d) Dritaret janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për t'u ndërruar _____ copë.

3. Gjendja teknike**3.1 Sistemi hidro/sanitar**

- a) Në gjendje të mirë: ☐☐
b) Rrjeti paraqet defekte dhe ka nevojë për t'u riparuar me vlerë _____ lekë:

3.2 Rrjeti elektrik

- a) Në gjendje të mirë: ☐☐
b) Rrjeti ka nevojë për riparime në _____ lekë:

3.3 Telefonia

- a) Në gjendje të mirë: ☐☐
b) Rrjeti ka nevojë për riparime në _____ lekë

3.4 Ngrohja

- a) Sistemi i ngrohjes në gjendje të mirë: ☐☐
b) Sistemi i ngrohjes është i dëmtuar dhe ka nevojë për _____ lekë riparime.

3.5 Pajisjet hidro-sanitare të banjës;

- a) Pajisjet janë në gjendje të mirë: ☐☐
b) Pajisjet nuk janë në gjendje të mirë kanë nevojë për t'u zëvendësuar:

Shënim. Formulari i inspektimit, shoqërohet me relacionin teknik dhe ekonomik sipas zërave të formularit dhe konkluzioneve të inspektimit.



VENDIM
Nr. 584, datë 22.7.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
570, DATË 17.7.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN,
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E AGJENCISË KOMBËTARE
TË PYJEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 2, të kreut IV, të vendimit nr. 570, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Për nëpunësit e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, të cilët kanë kryer funksione të lidhura me monitorimin dhe kontrollin në fushën e pyjeve, zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 587, datë 22.7.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË
BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË
DËMTUARA, NË ZONAT E SHPALLURA
PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, shkronja “a”, pika 1, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të

Faqe | 8514

ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 16 198 330 089 (gjashtëmbëdhjetë miliardë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e treqind e tridhjetë mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

2. Përdorimin e fondit, të miratuar në buxhetin e vitit 2020, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në masën 3 239 666 018 (tre miliardë e dyqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 3 239 666 018 (tre miliardë e dyqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim”, të buxhetit të shtetit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 588, datë 22.7.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 441, DATË 3.6.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR
FINANCIMIN E HARTIMIT TË
PROJEKTEVE PËR MIRATIMIN E
LEJEVE TË NDËRTIMIT, PËR
NDËRTIMIN E NJËSIVE TË BANIMIT
NË NDËRTESE (PALLAT), NË ZONAT
E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË
DETYRUAR, NË BASHKITË DURRËS,
KAVAJË, KRUIJË, KURBIN, LEZHË,
SHIJAK DHE VORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 441, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projekteve për miratimin e lejeve të ndërtimit, për ndërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Mirditë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë”.

2. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projektit për miratimin e lejeve të ndërtimit, përfshirë kostot për shërbime të rlevimeve topografike, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të

shërbimeve gjeologjike që i takojnë nëntokës e punimeve në themel, për ndërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë, në masën 254 159 368 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i kalohet fondi në masën në masën 254 159 368 (dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projekteve sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi.”.

II. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 589, datë 22.7.2020**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR NJË
NDRYSHIM NË KONTRATËN E
QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/
KONTRATA, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 642, DATË 2.10.2019, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e



ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

dhe

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për një ndryshim në kontratën e qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, miratuar me vendimin nr. 642, datë 2.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë “MTSC” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore “Ish-ndërmarrje metalike “Tirana” (Reparti i orëve), prona nr. 19, me numër pasurie 7/649, zona kadastrale 8220, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë”, të ndryshuar, sipas projektkontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ndërmarrja Industriale nr. 1, Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ rep.

Nr. _____ kol.

PROJEKTKONTRATË

ANEKSKONTRATË QIRAJE

lidhur

Në Tiranë, sot, më datë _____, të muajit _____, të vitit 2020 (dymijë e njëzet), u paraqitën para meje, noterit _____, palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar me autorizim të ministrit, nr. _____ nga z. _____, me detyrë _____, në këtë Ministri, i datëlindjes _____, banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare i pajisur me letërnjoftimin me numër personal _____, që më poshtë do të quhet “**Qiradhënës**”

Faqe | 8516

Shoqëria “MTSC” sh.p.k., me seli në Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), me numër identifikimi L51817008H, përfaqësuar nga administratorja e shoqërisë, znj. Vilma Theodhos, e identifikuar me kartën e identitetit me numër personal G75829026B, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet “**Qiramarrësi**”:

Të cilët deklaruan se:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, të ndryshuar, kërkesën subjektivit qiramarrës, për një ndryshim në kontratën e qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, miratuar me vendimin nr. 642, datë 2.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë “MTSC” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore “Ish-Ndërmarrja Metalike “Tirana” (Reparti i Orëve), prona nr. 19, me numër pasurie 7/649, zona kadastrale 8220, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë”, të ndryshuar, bazuar në nenet 801–825, të Kodit Civil, së bashku me “Qiramarrësin”, palët bien dakord të hartojnë këtë anekskontratë, me ndryshimet si vijon:

Neni 1

Në nenin 2 “Qëllimi i përdorimit” dhe në fjalinë e parë të pikës 5.7, të nenit 5 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”, fjalët “...rikonstruksionin total...”, zëvendësohen me “... rikonstruksionin minimalisht të totalit...”.

Neni 2

Anekskontrata është pjesë përbërëse e kontratës së qirasë nr. 2604 rep., nr. 727 kol., datë 14.10.2019 dhe shtesës së kontratës nr. 479



rep. dhe 189 kol., datë 28.2.2020 dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët.

Anekskontrata është formuluar në gjashtë kopje origjinale dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe pranuan, e nënshkruan atë para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë dhe unë noter _____, në bazë të nenit 801 e në vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë rregullisht.

QIRADHËNËSI	QIRAMARRËSI
Ministria e Financave	Shoqëria “MTSC”
dhe Ekonomisë,	sh.p.k.
Përfaqësuar nga:	Përfaqësuar nga:

VENDIM
Nr. 591, datë 24.7.2020

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND EDHE PËR KANDIDATË TË
TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE
PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË
PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË
TND PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 27, pika 5, dhe 29, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtimisht, për vitin 2020, procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND është e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në TND.

2. Për vitin 2020, pranimi në TND të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet një konkursi kombëtar.

3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 1 (një).

4. Kriteret minimale të pranimit për këtë procedurë, për kandidatët nga jashtë shërbimit civil, janë, si më poshtë vijon:

a) të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “dh”, të nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;

b) të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”, ose të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

c) të kenë, të paktën, 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlefshme në:

- institucione të administratës publike;
- institucione bankare të nivelit të dytë e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh e që aktualisht nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- organizata jofitimprurëse, të cilat kanë, të paktën, 5 (pesë) vjet që janë krijuar.

Përjashtimisht, kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë:

- në institucione ndërkombëtare brenda vendit;
- në profesion jashtë vendit;
- pedagogë në institucione të arsimit të lartë;
- avokatë, noterë apo kontabilistë të miratuar brenda ose jashtë vendit,

duhet të kenë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune, përkatësisht në këto institucione ose në profesion;

ç) të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative, të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.



5. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 1, datë 15.7.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 10.12.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË
PROCEDURAVE TË DHËNIES TË SË
DREJTËS SUBJEKTEVE JURIDIKE PËR
MARRJEN NË DISPOZICION TË
SIPËRFAQEVE TË PARASHIKUARA PËR
NDËRTIMIN E OBJEKTEVE E
ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË
PËRKATËSE NË ZONËN
ENERGJETIKE DHE INDUSTRIALE TË
PORTO-ROMANOS, DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 3, të vendimit nr. 703, datë 23.4.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e studimit “Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj””, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 8, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Ministria përgjegjëse për veprimtarinë energjetike dhe industriale, në vazhdim e quajtur “Ministria”, të informojë për zonat e përcaktuara për ndërtimin dhe përdorimin e objekteve energjetike dhe industriale, sipas skemës së vendosjes së tyre në hapësirat e përcaktuara me

vendimin nr. 703, datë 23.4.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e studimit “Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj””, në vazhdim i quajtur “Studimi”, si dhe për sipërfaqet për ndërtimin e tyre, sipas “Masterplanit”, të miratuar me vendimin nr. 2, datë 14.7.2009, të KRRTRSH-së.

Informimi të bëhet nëpërmjet publikimit të një materiali përmbledhës për “Masterplanin” dhe këtij udhëzimi në faqen e internetit të “Ministrisë”.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

3. Shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 7, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) informacion mbi strukturën organizative të shoqërisë dhe NUIS;”.

“c) Kopjen e vendimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose njoftimin që projekti t’i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, bazuar në Vlerësimin Strategjik Mjedisor, si dhe në studime e vlerësime mjedisore për “Zonën”.”.

4. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Trajtimi i kërkesave nga strukturat përgjegjëse të “Ministrisë”, si dhe realizimi i vlerësimit të tyre nga grupi i punës, i ngritur me urdhër ministri, bëhen brenda një periudhe jo më shumë se një muaj nga data e paraqitjes së kërkesës, si më poshtë vijon:

a) në përfundim të vlerësimit, në rastin kur ai konsiderohet i pranueshëm, i propozohet “Ministrit” t’i japë subjektit kërkuar “autorizimin” për vënien në dispozicion të sipërfaqes për ndërtimin e objektit dhe instalimin e teknologjisë përkatëse në zonën e kërkuar;

b) në rast se, sipas vlerësimit që i bëhet aplikimit të paraqitur nga subjekti, rezulton se shtrirja hapësinore, natyra dhe destinacioni i veprimtarisë së objektit që kërkohet të ndërtohet në një sipërfaqe të caktuar të “Zonës”, nuk janë sipas kushteve të “Masterplanit”, por objekti i përket fushave të energjetikës e industrisë dhe për këtë sipërfaqe nuk ka një propozim alternativ, sipas kushteve të “Masterplanit”, dhe grupi i punës e vlerëson të pranueshëm këtë aplikim, në këtë rast i propozohet “Ministrit” që t’i japë subjektit kërkuar “autorizimin” për



vënien në dispozicion të sipërfaqes për ndërtimin e objektit dhe instalimin e teknologjisë përkatëse në zonën e kërkuar sipas propozimit përkatës;

Dhënia e autorizimit duhet të bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data kur grupi i punës ka përfunduar vlerësimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti.

c) Në rast se pas përfundimit të vlerësimit rezulton se objekti, që kërkohet të ndërtohet dhe teknologjia që do të instalohet në të, nuk janë të fushave të energjetikës dhe të industrisë dhe nuk janë në përputhje me destinacionin e përcaktuar në “Masterplan”, grupi i punës i “Ministrit” i paraqet “Ministrit” argumentimin e vlerësimit, duke propozuar që t’i kthehet subjektit praktika përkatëse, shoqëruar me arsyetimin për këtë qëndrim.

ç) Në rast se rezulton se subjekti nuk ka plotësuar qoftë edhe njërin nga kërkesat e pikës 7, të këtij udhëzimi, atëherë subjektit i kthehen dokumentet për plotësim.

Në rastin kur subjekti nuk është dakord me vlerësimin e “Ministrit”, mund të bëjë ankim në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

5. Në pikën 10, fjalët “... brenda periudhës që bëhet vlerësimi i kërkesave ...” hiqen.

6. Shkronjat “b” dhe “dh”, të pikës 11, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) E drejta e subjektit për të investuar në zonën përkatëse, në përputhje me “Masterplanin”, duke identifikuar territorin për investim. Procedurat e dhënies së lejes së ndërtimit duhet të kryhen në përputhje me kërkesat e ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij.”.

“dh) Marrëdhëniet me infrastrukturën portuale, të ndërtuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe me instalimet bregdetare për transportimin dhe depozitimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në “Zonë” (depozitat dhe tubacionet me pajisjet përkatëse), në rast se kjo është një kërkesë e teknologjisë që do të instalojë dhe do të përdorë subjekti.”.

7. Në pikën 12, shkurtimi “KRRTRSH” zëvendësohet me “KKT”.

8. Pika 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

“16. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIMI I PËRBASHKËT Nr. 18, datë 1.7.2020

PËR PROCEDURAT E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 25 dhe 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit të arsimit parauniversitar”; dhe të vendimit nr. 227, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”,

UDHËZIJMË:

Përdorimin e fondeve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit të arsimit parauniversitar dhe ndjekja e procedurave, si më poshtë:



KREU I

BOTIMI, SHTYPJA DHE PAJISJA ME
HOLOGRAMË E TEKSTEVE SHKOLLORE

1. Procesi i shtypjes, botimit, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollorë të sistemit të arsimit parauniversitar, realizohet nga shtëpitë botuese dhe/ose distributorët e autorizuar.

2. Tekstet shkollorë, përpara se të botohen dhe të shpërndahen për shitje, duhet të jenë të certifikuara, me certifikatën e lejes për të hyrë në tregun e shitjes, si dhe të kenë të vendosur në kopertinë pullën me hologramë, e cila furnizohet nga MASR-ja.

3. Pullat me hologramë u jepen shtëpive botuese dhe distributorëve, kundrejt kostos së blerjes nga MASR-ja. Të ardhurat e realizuara nga dhënia e pullës me hologramë derdhen 100 për qind në buxhetin e shtetit.

KREU II

PËRZGJEDHJA DHE POROSIA E
TEKSTEVE SHKOLLORE

1. Shtëpitë botuese/distributorët, për tekstet shkollorë të shpallura fituese dhe të përfshira në katalogun zyrtar të teksteve shkollorë, i paraqesin ato për përzgjedhje në bazë shkolle, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin përkatës të MASR-së. Lista e teksteve shkollorë të përzgjedhura mbi bazë shkolle i njoftohet çdo botuesi/distributori, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin përkatës të MASR-së.

2. Çdo drejtor shkolle, me anë të një kërkesë, bën porosinë zyrtarisht dhe përmes postës elektronike te botuesi/distributori për tekstet e nxënësve të shkollës së tij, që përfitojnë tekstet shkollorë në përdorim falas dhe sasinë e teksteve që nuk përfitohen falas nga nxënësit, pas rakordimit të listës së teksteve shkollorë me zyrën përkatëse vendore të arsimit parauniversitar. Në kërkesë parashikohet sasia e teksteve për çdo titull, nga titujt e përzgjedhur pjesë e katalogut zyrtar të teksteve shkollorë të publikuar nga MASR-ja. Porosia për tekste shkollorë duhet të përfshijë/parashikojë të gjithë nxënësit e arsimit bazë dhe nxënësit e shkollave të arsimit të mesëm të lartë. Një kopje e kësaj kërkesë i dërgohet dhe zyrës vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP). Drejtori i secilës shkollë paraqet pranë ZVAP-së,

brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve që përfitojnë tekste shkollorë në përdorim falas dhe dokumentacionin provues për secilën kategori.

3. Çdo drejtor i shkollave ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, me anë të një kërkesë, bën porosinë për tekste shkollorë për këtë kategori nxënësish në ZVAP-në përkatëse. ZVAP-ja përkatëse, brenda muajit janar të çdo viti, paraqet kërkesën në MASR për vitin e ardhshëm shkollor për të gjitha tekstet shkollorë për pakicat kombëtare për shkollat në varësinë e saj. Në kërkesë, parashikohet sasia e teksteve për çdo titull, nga titujt e përzgjedhur pjesë e katalogut zyrtar të teksteve shkollorë të publikuar nga MASR-ja.

4. Nxënësit që gëzojnë statusin e “të verbrit”, të cilët mësojnë në klasat I deri IX, pajisen me tekste shkollorë specifike për këtë kategori të transkriptuara në shkrimin *brail*, të regjistruara në audio ose shkrim të zmadhuar. Këto tekste shkollorë janë pronë e shkollës dhe afati i përdorimit të tyre është tre vjet ose më shumë, në varësi nga konsumi i tyre. Administrimi i kërkesave për prodhimin/shumëfishimin e këtyre teksteve, si dhe pajisja me libra e nxënësve të verbër realizohet nga Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë, në Tiranë. Drejtoritë përkatëse të shkollave ku mësojnë nxënës të verbër, duhet të dorëzojnë në ZVAP-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie, për çdo klasë të vitit pasardhës shkollor.

KREU III

PROCEDURAT E PËRDORIMIT TË
FONDEVE BUXHETORE PËR TEKSTET
SHKOLLORE

1. Shtëpitë botuese/distributorët tregtojnë tekstet shkollorë në libraritë, si dhe mjediset e shkollave. Drejtorët e shkollave u ofrojnë një ose dy mjedise shtëpive botuese/distributorëve për shitjen e teksteve. Shitja realizohet nga vetë shtëpitë botuese ose nënkontraktorët e tyre. Çmimi i shitjes së tekstit duhet të jetë jo më i lartë se çmimi zyrtar i miratuar për secilin tekst shkollor dhe i publikuar në katalogun e MASR-së, si dhe të përfshijë edhe TVSH-në në rast se është e aplikueshme, sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

2. Shtëpitë botuese/distributorët duhet të lëshojnë për çdo blerës, faturën tatimore të shitjes. Në fund të çdo dite, botuesi/distributori regjistron



në pajisje fiskale të gjitha transaksionet e evidentuara në bazë të faturave tatimore të shitjes. Këto transaksione duhet të jenë pjesë e raportit tatimor ditor të pajisjes fiskale që shërben për të kryer mbylljen ditore të aktivitetit të botuesit.

3. Shtëpitë botuese/distributorët duhet të lëshojnë për çdo institucion arsimor (shkollë), faturën tatimore të shitjes, për sasinë e teksteve shkollore të shitura për shkollën përkatëse, sipas porosisë së kryer nga shkolla dhe rakorduar me ZVAP-në përkatëse, për të gjitha kategoritë që përfitojnë tekste shkollore falas, në zbatim të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”. Fatura tatimore dhe akt rakordimi nënshkruhet nga të dyja palët.

4. Shtëpitë botuese/distributorët duhet të lëshojnë për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, faturën tatimore të shitjes, për sasinë e teksteve shkollore të botuara/shtypura për pakicat kombëtare, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 227, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”.

5. Fondet e buxhetit të shtetit të miratuara për çdo vit për MASR-në, do të përdoren nga institucioni arsimor/ZVAP, për të përballuar vlerën e blerjes së teksteve shkollore.

6. Prindërit apo përfaqësuesit ligjorë të nxënësve të klasave VIII dhe IX dhe arsimin e mesëm të lartë, dorëzojnë në drejtorinë e institucionit arsimor përkatës dokumentacionin, që vërteton statusin në zbatim të pikës 6, të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit të arsimit parauniversitar”, për t’u konsideruar përfitues të teksteve shkollore falas. Drejtoria e institucionit arsimor përkatës harton listat për çdo klasë dhe për të gjithë shkollën dhe, brenda datës 30 shtator, i dërgon ato në ZVAP-të përkatëse, në formë zyrtare dhe elektronike (sipas formularit nr. 1 dhe formularit nr. 1.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi).

7. ZVAP-ja, brenda datës 10 tetor, dërgon në MASR kërkesën për fonde buxhetore të detajuar

sipas niveleve arsimore/buxhetore, për arsimin bazë për arsimin e mesëm të përgjithshëm.

8. MASR-ja çel fondet e miratuara, për vitin përkatës buxhetor dhe i kalon ato në llogari të DRAP/ZVAP-ve pranë degëve të thesarit në rrethe. Menjëherë pas marrjes së njoftimit nga MASR-ja për çeljen e fondeve në programin dhe artikullin përkatës buxhetor, institucioni përgjegjës paraqet pranë degëve të thesarit dokumentacion justifikues mbi bazën e të cilit bëjnë kalimin/xhirimin e fondeve, për llogari të shtëpive botuese/distributorëve në bankat e nivelit të dytë.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Tekstet shkollore që blihen në tregun e lirë, pa faturë tatimore, në asnjë rast dhe për asnjë arsye, prindi apo nxënësi, drejtoria e shkollës nuk mbështeten me fonde nga buxheti i shtetit.

2. Tekste shkollore që tregtohen pa pullën me hologramë i nënshtrohen procesit të konfiskimit në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Përgjithshëm, për vitin shkollor 2020–2021, afatet e kërkesave nga institucionet arsimore dhe ZVAP-të, paraqiten brenda datës 10 gusht 2020.

4. Udhëzimi i përbashkët nr. 51, datë 20.9.2013, i ministrit të Financave dhe i ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për procedurat e përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, zyrtarë vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj



Formular nr. 1

Kërkesë e shkollës _____ drejtuar ZVAP-së, për mbështetje me fonde buxhetore për shtëpitë botuese/ distributorët në “arsimin bazë”

Nr.	Emri, mbiemri/nxënësit/prindërit	Emri/shkollë	Klasa 1-7	Statusi i përfutimit, sipas pikës 6, të VKM-së, mbështetur në vendimet e njësisë së pushtetit vendor, apo sipas pikave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” etj.	Fatura nr., datë e shtëpisë botuese	Nr. i NIPT-it të shtëpisë botuese “Drita”, “Dielli”, “Hëna” etj.	Sasia e teksteve të blera/copë	Vlera e teksteve, në lek (shuma që konfirmohet prind/nxënës, në lek)	Nr. dokumenti i identitetit për prindin që konfirmon marrjen/pajisjen me tekste shkollë nga prindi/në emër të nxënësit	Emri, mbiemri, nënshkrimi për prindin që konfirmon pajisjen me tekste shkollë të fëmijës/nxënës
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ermal Dritan Peto	Delvinë	I	Pikës “a”	Nr. 15, datë 1.9.2018	J21424005 U	5	2.800	Plotësohet ditën kur tërhiqen tekstet shkollë	Plotësohet datën kur tërhiqen tekstet në klasë/shkollë
2	Denisa Paskal Naçe	Delvinë	I	Pikës “b”	Nr. 15, datë 1.9.2018		5	2.800		
		Delvinë	I	etj.						
25	Onion Sokol Vrapit	Delvinë	I		Nr. 8, datë 2.9.2018		5	2.500		
					TOTALI			8.100		

Formular nr. 1.1

Kërkesë e shkollës _____ drejtuar DAR/ZA-së, për mbështetje me fonde buxhetore për shtëpitë botuese/distributorët në “arsimin e mesëm”

Nr.	Emri, mbiemri/nxënësit/prindërit	Emri/shkollë	Klasa 10-12	Statusi i përfutimit, sipas pikës 6, të VKM-së, mbështetur në vendimet e njësisë së pushtetit vendor, apo sipas pikës “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” etj.	Fatura nr., datë e shtëpisë botuese	Nr. i NIPT-it të shtëpisë botuese “Drita”, “Dielli”, “Hëna” etj.	Sasia e teksteve të blera/copë	Vlera e teksteve në lekë (shuma që konfirmohet prind/nxënës në lekë)	Nr. dokumenti i identitetit për prindin që konfirmon marrjen/pajisjen me tekste shkollë nga prindi/në emër të nxënësit	Emri, mbiemri, nënshkrimi për prindin që konfirmon pajisjen me tekste shkollë të fëmijës/nxënës
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Andri Erjon Pano	Delvinë	X	Pikës “a”	Nr. 25, datë 3.9.2018	J21424005 U	9	3.800	Plotësohet ditën kur tërhiqen tekstet shkollë	Plotësohet datën kur tërhiqen tekstet në klasë/shkollë
2	Sokol Pirro Duro	Delvinë	X	Pikës “b”	Nr. 25, datë 3.9.2018		9	3.800		
		Delvinë	X	etj.						
25	Anisa Niko Duro	Delvinë	X		Nr. 25, datë 3.9.2018		8	3.500		
					TOTALI		220	92.500		

**UDHËZIM****Nr. 11, datë 17.7.2020****PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
MODALITETET, AFATET DHE
MËNYRËN E KAKTIMIT TË
PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT
ZËVENDËSUES**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe të pikës 3, të nenit 48, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat e zbatueshme për modalitetet, afatet dhe mënyrën e caktimit të përmbaruesit gjyqësor privat zëvendësues nga ministri i Drejtësisë, në rastet e parashikuara në ligjin “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

2. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë miraton, jo më vonë se data 10 shkurt të çdo viti kalendarik, listën me përmbaruesit gjyqësorë privatë zëvendësues të përzgjedhur sipas procedurave të përcaktuara në këtë urdhër.

3. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë cakton përmbaruesit gjyqësorë privatë në listë pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikën 4, të këtij udhëzimi.

4. Përmbaruesi gjyqësor privat, që kërkon të përfshihet në listën përfundimtare të përmbaruesve gjyqësorë privatë zëvendësues, të miratuar nga Dhoma, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- b) të ketë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë profesionale si përmbarues;
- c) ndaj tij të mos ketë filluar procedimi disiplinor në kohën e paraqitjes së kërkesës për t’u përfshirë në listë.

5. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, jo më vonë se data 10 dhjetor e çdo viti, publikon në faqen zyrtare të saj njoftimin për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga përmbaruesit gjyqësorë privatë, për t’u përfshirë në

listën e përmbaruesve gjyqësorë privatë zëvendësues. Thirrja për shprehjen e interesit:

a) duhet të jetë e hapur për të paktën 2 (dy) javë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të tyre, si dhe

b) duhet të përcaktojë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për t’u dorëzuar bashkë me shprehjen e interesit.

6. Përmbaruesit e interesuar për të qenë zëvendësues, duhet të depozitojnë me postë, dorazi në protokollin e Dhomës ose në rrugë elektronike dokumentacionin vërtetues të plotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 4, të këtij udhëzimi.

7. Jo më vonë se data 15 janar e çdo viti kalendarik, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë verifikon nëse përmbaruesit që kanë paraqitur shprehjen e interesit plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 4, të këtij udhëzimi. Lista me përmbaruesit, që i plotësojnë kushtet, bëhet publike në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

8. Përmbaruesit e përjashtuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit pranë ministrit të Drejtësisë. Ministri vendos brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Ndaj vendimit të ministrit mund të paraqitet ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë.

9. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të afatit të ankimit ose pas shqyrtimit të ankimeve nga ministri, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë miraton listën me përmbaruesit gjyqësorë privatë zëvendësues dhe ia njofton atë ministrit të Drejtësisë, si dhe e publikon në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

10. Lista e miratuar është e vlefshme deri me miratimin e listës për vitin pasardhës, sipas procedurave të këtij udhëzimi.

11. Ministri i Drejtësisë, për caktimin e përmbaruesit gjyqësor privat zëvendësues, bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) nëse përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues është në situatën e konfliktit të interesit me subjektet përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor privat që zëvendëson;

b) nëse përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues ushtron veprimtari në të njëjtën rreth



gjyqësor apo në një rreth gjyqësor të afërt më atë në të cilin ushtron veprimtarinë përmbaruesi gjyqësor privat që zëvendësohet;

c) vëllimin e punës së veprimtarisë përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor privat zëvendësues;

ç) ndaj përmbaruesit gjyqësor zëvendësues të mos ketë filluar procedimi disiplinor në kohën e caktimit si zëvendësues.

12. Në urdhër përcaktohet data e fillimit të veprimtarisë si zëvendësues dhe afati i kryerjes së detyrës si përmbarues gjyqësor privat zëvendësues, sipas ligjit për përmbarimin gjyqësor privat.

13. Përjashtimit, ministri i Drejtësisë nuk cakton një përmbarues gjyqësor privat zëvendësues sipas kësaj liste, në rastet kur përmbaruesi gjyqësor privat bën kërkesë për pezullim të përkohshëm, sipas parashikimit të nenit 26, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” dhe propozon caktimin e një përmbaruesi gjyqësor privat tjetër si zëvendësues i tij. Në këtë rast, ministri në urdhrin e pezullimit cakton edhe përmbaruesin privat zëvendësues sipas propozimit.

14. Përmbaruesi që zëvendësohet është i detyruar t'i kalojë dhe t'i lejojë përmbaruesit privat zëvendësues aksesin e plotë për çështjet përmbarimore që janë në ekzekutim aktiv vazhdues dhe/ose çështjet që janë të pezulluara, që sipas kërkesës së subjektit kreditor vlerësohet se duhet të rifillojnë nga përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues apo detyrohen të rifillojnë sipas një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

15. Në rastin kur përmbaruesi gjyqësor është pezulluar ose çregjistruar nga regjistrat për shkaqet e parashikuara në nenin 28, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” ose për shkak të vdekjes, përmbaruesit gjyqësor privat zëvendësues, të caktuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, i dorëzohen dosjet nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë që i ka administruar ato sipas parashikimeve të udhëzimit “Për caktimin e procedurës dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbaruesi gjyqësor privat dhe/ose zyrtat e përmbarimit privat, të arkivit dhe vulës personale”.

16. Përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues ka të njëjtat të drejta dhe detyrime, si përmbaruesi gjyqësor privat që zëvendëson, për atë kohë sa kryen veprimtari përmbarimore në lidhje me

çështjet përmbarimore që vazhdojnë për shkak të zëvendësimit të tij.

17. Përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues, jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga fillimi i zëvendësimit, njofton palët në çështjen përmbarimore për vijimin, vazhdimin dhe ndjekjen e procedurave përmbarimore.

18. Përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues, duhet të ketë një llogari bankare të veçantë në emrin e tij, për t'u përdorur vetëm për depozitimin e vlerave monetare të ardhura nga procedura përmbarimore vijuese dhe/ose për të mundësuar transfertat e vlerave monetare në zhvillimin deri në përfundimin e procesit përmbarimor apo deri në ardhjen e përmbaruesit gjyqësor privat që zëvendësohet.

19. Në rast se gjatë periudhës së njoftimit të zëvendësimit të përmbaruesit, debitori në padijeninë e tij, ekzekuton pjesërisht ose plotësisht detyrimin në llogarinë bankare të përmbaruesit gjyqësor privat që zëvendësohet, pavarësisht zëvendësimit, ky i fundit është i detyruar të kryejë transfertën e shumave kundrejt palës kreditore ose të autorizojë përmbaruesin zëvendësues të bëjë transfertat nga llogaria bankare në emër e për llogari të tij kundrejt palës kreditore.

20. Përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues transferon në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor privat që zëvendësohet të gjitha vlerat monetare që ndodhen në llogarinë e tij të veçantë, kur përfundon së kryeri veprimtarinë përmbarimore për shkak të zëvendësimit, brenda 2 (dy) ditëve sapo rifillon veprimtarinë përmbaruesi gjyqësor privat që zëvendësohet.

21. Me përfundimin e veprimtarisë përmbarimore për shkak të zëvendësimit, përmbaruesi gjyqësor privat që zëvendësohet, detyrohet që të transferojë në llogarinë e veçantë të përmbaruesit gjyqësor privat zëvendësues brenda 10 (dhjetë) ditësh, një pjesë të tarifës fikse dhe/ose të suksesit në një masë në proporcion me punën dhe me veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues gjatë veprimtarisë së tij zëvendësuese.

22. Në kryerjen e veprimeve përmbarimore gjatë periudhës së zëvendësimit, përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues pasqyron emrin dhe mbiemrin e tij dhe përdor vulën e vet.

23. Me përfundimin e zëvendësimit, përmbaruesi gjyqësor privat zëvendësues i kthen



përmbauesit gjyqësor të zëvendësuar prej tij të gjithë dokumentacionin e çështjeve përmbaimore mbi të cilin ka zhvilluar veprimtari gjatë periudhës së zëvendësimit. Përmbauesi gjyqësor privat i zëvendësuar njofton për këtë fakt palët e procesit përmbaimator, si dhe gjithë institucionet shtetërore, personat juridikë publikë dhe privatë, që kanë lidhje me procedurat e ekzekutimit përmbaimator jo më vonë se 3 (tri) ditë nga rifillimi i veprimtarisë përmbaimore dhe marrjes së të drejtave procedurale nga përmbauesi që e zëvendësoi përkohësisht.

24. Afatet procedurale nuk cenohen dhe vazhdojnë pa asnjë pengesë për kryerjen e veprimeve procedurale vijuese, të mbetura dhe/ose që rifillojnë në çastin e përfundimit të zëvendësimit apo të fillimit të veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor privat zëvendësues.

25. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë dhe çdo përmbaues gjyqësor privat për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

UDHËZIM
Nr. 12, datë 17.7.2020

**PËR CAKTIMIN E PROCEDURËS DHE
AFATET E DORËZIMIT TË
DOKUMENTACIONIT NGA
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT
DHE/OSE ZYRAT E PËRMBARIMIT
PRIVAT, TË ARKIVIT DHE TË VULËS
PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 43, pika 4, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimator gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:

1. Në rast se përmbauesit gjyqësor privat i hiqet licenca ose çregjistrohet nga regjistrat e

përmbauesve gjyqësorë privatë dorëzon në Ministrinë e Drejtësisë, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, vulën personale, mjetin e identifikimit profesional, çështjet përmbaimore të papërfunduara në proces ekzekutimi, si dhe në rastin e çregjistrimit nga regjistrat e përmbauesve gjyqësorë privatë, arkivin e krijuar prej fillimit të veprimtarisë së tij.

2. Ministri i Drejtësisë përcakton me urdhër ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të vulës personale, mjetit të identifikimit profesional, çështjet përmbaimore të papërfunduara në proces ekzekutimi, si dhe në rastin e çregjistrimit nga regjistrat e përmbauesve gjyqësorë privatë, arkivin e krijuar prej fillimit të veprimtarisë së tij.

3. Për marrjen e vulës personale, mjetit të identifikimit profesional dhe arkivit, personi (ish-përmbauesi, personi i ngarkuar prej tij përmes prokurës së posaçme apo personi që ka në ruajtje arkivin), njoftohet të paktën 5 (pesë) ditë përpara për ditën dhe orën e dorëzimit, përmes shërbimit postar dhe/ose në rrugë elektronike. Njoftimi nëpërmjet shërbimit postar kryhet përmes postës së porositur.

4. Kur personit nuk i dihet vendbanimi, si dhe kur njoftimi nuk mund të kryhet në asnjë prej vendeve të përcaktuara në nenin 151, të Kodit të Procedurës Administrative, kryhet njoftimi publik sipas parashikimit të nenit 162, të Kodit të Procedurës Administrative.

5. Komisioni i marrjes në dorëzim të vulës personale, mjetit të identifikimit profesional, çështjet përmbaimore të papërfunduara në proces ekzekutimi, si dhe arkivit, i merr në dorëzim me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe ish-përmbauesi ose personi i autorizuar për t'i dorëzuar ato. Në qoftë se ish-përmbauesi ose personi i autorizuar refuzon nënshkrimin e procesverbalit, Komisioni i marrjes në dorëzim bën shënimin përkatës në procesverbal dhe kur është e mundur, e vërteton me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm faktin e refuzimit të nënshkrimit.

6. Çështjet përmbaimore të papërfunduara i dorëzohen nga Komisioni i marrjes në dorëzim, përmbauesit gjyqësor privat zëvendësues të caktuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë. Deri në datën e caktimit të përmbauesit privat zëvendësues me urdhër të ministrit, këto dosje ruhen në



Sektorin e Protokoll-Arkivit në Ministrinë e Drejtësisë.

7. Arkivi i krijuar prej fillimit të veprimtarisë së përmbauesit i dorëzohet me procesverbal nga Komisioni i marrjes në dorëzim Sektorit të Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë.

8. Vula dhe mjeti i identifikimit personal nxirren jashtë përdorimit me procesverbal nga një komision i përcaktuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, në të cilin përfshihen dy nëpunës të Ministrisë së Drejtësisë dhe një anëtar i Dhomës Kombëtare të Përmbaimit.

9. Në rast moszbatimi vullnetar, urdhri i ministrit të Drejtësisë për dorëzimin e vulës personale, mjetin e identifikimit profesional, çështjet përmbaimore të papërfunduara në proces ekzekutimi, si dhe në rastin e çregjistrimit nga regjistrat e përmbauesve gjyqësorë privatë, arkivin e krijuar prej fillimit të veprimtarisë së tij, të përmendura në këtë urdhër, përbën titull ekzekutiv.

10. Ministria e Drejtësisë merr masa për ndjekjen e procedurave ligjore për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit mbi titullin ekzekutiv. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon sektorit të përfaqësimit gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Sektori i përfaqësimit gjyqësor paraqet në gjykatë kërkesën brenda 20 (njëzet) ditëve nga përfundimi i afatit, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij urdhri. Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë i kërkon Zyrës së Përmbaimit Shtetëror vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.

11. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë dhe përmbauesit gjyqësorë privatë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

UDHËZIM

Nr. 13, datë 17.7.2020

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE SHPËRBLIMIT TË EKSPERTËVE TË JASHTËM TË PAVARUR, TË CILËT ANGAZHOHEN NË KRYERJEN E KONTROLLEVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 58, pika 8, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimit gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve, procedurave të përzgjedhjes dhe shpërbimit të ekspertëve të jashtëm të pavarur, të cilët angazhohen për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së përmbauesve gjyqësorë privatë, në rastin e mungesës së burimeve njerëzore në strukturën përgjegjëse në ministri, si dhe mbulimit të fushave specifike.

2. Ministria e Drejtësisë miraton jo më vonë se data 10 shkurt të çdo viti kalendarik, një listë me jo më pak se 25 (njëzet e pesë) ekspertë të jashtëm të pavarur, që mund të angazhohen për kryerjen e kontrolleve, të përzgjedhur sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Procesi i paraqitjes, trajtimit të shprehjes së interesit dhe të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët, bëhet duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor, si edhe parimet e përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, të drejtësisë, të paanësisë, të mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror.

4. Kandidati që kërkon të përfshihet në listën e ekspertëve të pavarur, që mund të angazhohet për kryerjen e kontrolleve, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, ekonomi, shkenca



inxhinierike ose në një fushë tjetër të ngjashme me të, me diplomë “Master i shkencave”;

c) të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në profesion;

ç) të mos jetë i dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë i pushuar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi në çastin e paraqitjes së shprehjes së interesit;

dh) të ketë një profil të spikatur shoqëror, integritet të lartë moral dhe përgatitje të lartë profesionale;

e) të mos jetë përmbarues ose bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë të mos jenë përmbarues;

ë) në kohën e kandidimit, të mos ketë qenë i punësuar ose i angazhuar si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat, për të paktën 5 (pesë) vjet, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, pranë një përmbaruesi ose zyre përmbarimore private.

5. Ministria e Drejtësisë, jo më vonë se data 10 dhjetor e çdo viti publikon në faqen zyrtare të saj njoftimin për paraqitjen e shprehjeve të interesit për t'u përfshirë në listën e ekspertëve të pavarur. Thirrja për shprehjen e interesit:

a) duhet të jetë e hapur për të paktën dy javë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të tyre; si dhe

b) duhet të përcaktojë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për t'u dorëzuar bashkë me shprehjen e interesit.

6. Kandidati i interesuar për t'u përfshirë në listën e ekspertëve të pavarur, duhet të depozitojë me postë, dorazi në protokollin e Ministrisë së Drejtësisë, apo në rrugë elektronike, dokumentacionin vërtetues të plotësimit të kushteve, si më poshtë:

a) shprehjen e interesit me shkrim;

b) jetëshkrimin e përditësuar;

c) kopje të dokumentit të identifikimit;

ç) kopje të diplomës, që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për fushën përkatëse të ekspertizës, ose diplomë të njësuar me të;

d) kopje të librezës së punës ose vërtetim se kandidati ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore për tre muajt e fundit;

dh) autorizim për verifikimin e gjendjes gjyqësore;

ë) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk ka asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërmit të shkallës së parë që është përmbarues gjyqësor privat në detyrë;

f) një deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk ka qenë i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme ose nuk ka qenë i angazhuar si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat për të paktën 5 (pesë) vjet, pranë një përmbaruesi ose zyre përmbarimore private;

g) çdo dokument tjetër që vërteton përmbushjen e kushtit të parashikuar në pikën 4, shkronja “dh”, të këtij udhëzimi.

7. Jo më vonë se data 15 janar e çdo viti kalendarik, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë verifikon nëse kandidatët që kanë paraqitur shprehjen e interesit plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 4, të këtij udhëzimi. Lista me kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet bëhen publike në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

8. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit pranë ministrit të Drejtësisë. Ministri vendos brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Ndaj vendimit të ministrit mund të paraqitet ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë.

9. Jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të afatit të ankimit ose pas shqyrtimit të ankimeve nga ministri, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë i përcjell ministrit për miratim listën me ekspertët e pavarur, e cila, pas miratimit, publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

10. Në rast se në përfundim të procedurave si më sipër, lista me ekspertë të pavarur ka më pak se 25 (njëzet e pesë) ekspertë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë pas kalimit të 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të listës, sipas pikës 9 të këtij udhëzimi, rishpall thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit sipas pikës 5, të këtij udhëzimi. Thirrja shpallet çdo 30 (tridhjetë) ditë pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes, sipas këtij udhëzimi, deri sa lista e ekspertëve të pavarur të ketë jo më pak se 25 (njëzet e pesë) ekspertë.



11. Lista e miratuar është e vlefshme deri me miratimin e listës për vitin pasardhës, sipas procedurave të këtij udhëzimi.

12. Masa e shpërblimit të ekspertëve të përzgjedhur është në vlerën 7 000 (shtatë mijë) lekë për ditë pune, në të cilat do të angazhohen, dhe pasqyrohet në kontratën e shërbimit që do të nënshkruhet me çdo ekspert të pavarur të përzgjedhur, kontratë në të cilën do të detajohen edhe kushtet dhe mënyra e livrimit të saj.

13. Në rastet kur eksperti i jashtëm dërgohet për inspektim jashtë qendrës së tij të punës, ai trajtohet edhe me dietë, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

14. Pagesa e ekspertëve të jashtëm përballohet nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

15. Për kryerjen e një inspektimi, ministri, me urdhër, cakton një ose disa ekspertë nga lista e ekspertëve të pavarur, të miratuar sipas këtij udhëzimi. Urdhri i ministrit të Drejtësisë, për përzgjedhjen e ekspertit dhe pjesëmarrjen e tij në inspektimin përkatës, përmban:

a) detyrat që i caktohen ekspertit;

b) afatin për paraqitjen nga eksperti pranë Ministrisë së Drejtësisë, të raportit me shkrim ku parashtrihen përfundimet e ekspertimit;

c) sipas rastit, urdhërimin e subjekteve të treta për t'i lejuar ekspertit kryerjen e detyrave të caktuara nga ministri i Drejtësisë.

16. Urdhri sipas pikës 15 të këtij udhëzimi, i bëhet i njohur ekspertit të pavarur, duke i njoftuar edhe datën e paraqitjes në inspektimin përkatës, të caktuar nga ministri i Drejtësisë.

17. Ministri i Drejtësisë i cakton ekspertit të përzgjedhur nga lista e ekspertëve, çështjet për të cilat duhet të merret mendimi me shkrim i tij. Përgjegjësia për saktësinë dhe vërtetësinë e ekspertimit, brenda fushës së kompetencës, i mbetet ekspertit. Eksperti është i detyruar të shpërblejë dëmet që për faj të tij i janë shkaktuar përmbaruesit ose zyrës përmbarimore private ndaj së cilës zhvillohet inspektimi apo palëve të tjera, të përfshira në procesin e inspektimit.

18. Eksperti është i detyruar të përmbushë detyrat e ngarkuara nga ministri i Drejtësisë, sipas afateve të përcaktuara, përveç kur parashtron shkaqe të arsyeshme që pranohen nga ministri i Drejtësisë. Eksperti, që nuk pranon të kryejë detyrën, duhet t'i njoftojë me shkrim ministrit të Drejtësisë shkaqet përkatëse të paktën 5 (pesë) ditë

përpara datës së inspektimit. Mospërmbushja në mënyrë të përsëritur e detyrave të caktuara nga ministri i Drejtësisë, pa shkaqe të arsyeshme, sjell përjashtimin e ekspertit nga lista.

19. Ekspertët e përzgjedhur, brenda kompetencave të dhëna me ligj, janë plotësisht të pavarur në kryerjen e ekspertimit dhe në paraqitjen e përfundimit të ekspertimit për rastin konkret.

20. Eksperti i përzgjedhur ka të drejtë të kryejë veprimet e mëposhtme:

a) të njihet me materialet e çështjes për inspektim;

b) t'i bëjë pyetje përmbaruesit, përfaqësuesit ligjor të zyrës përmbarimore ose çdo punonjësi tjetër të zyrës përmbarimore, pranë të cilit bëhet inspektimi, sipas fushës specifike për të cilën është angazhuar eksperti në këtë inspektim;

c) të japë shpjegime;

ç) të kërkojë e të marrë të dhëna nga të tretët, brenda kufijve të nevojshëm për kryerjen e detyrës.

21. Ministri i Drejtësisë i kërkon ekspertit të pavarur që të japë përfundimet e ekspertimit, sipas detyrave të dhëna në fillim të inspektimit, në një raport me shkrim, ku duhet të gjejnë pasqyrim edhe vërejtjet apo kërkesat e nëpunësit të strukturës përgjegjëse për inspektimin në Ministrinë e Drejtësisë, pjesë e ekipit të inspektimit apo edhe të përmbaruesit ndaj të cilit kryhet inspektimi. Në rastin e të metave, vërejtjeve apo paqartësive të mundshme, ministri i Drejtësisë mund të kërkojë sqarime plotësuese ose të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri, duke thirrur ekspertë të tjerë të pavarur nga lista e ekspertëve.

22. Ky udhëzim zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, përmbaruesit gjyqësorë privatë, si dhe zyrat përmbarimore private.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)



URDHËR

Nr. 219, datë 17.7.2020

**PËR KRIJIMIN, MBAJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E ARKIVIT NGA
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të germës “I”, të nenit 14, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Përbaruesi gjyqësor privat ruan dhe administron arkivin e krijuar prej tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë përbarimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat, si dhe rregullat e parashikuara në këtë urdhër. Nëse një ose disa përbarues gjyqësorë privatë organizohen në zyrë të përbarimit privat, çdo përbarues gjyqësor privat është i detyruar të ruajë dhe të administrojë arkivin e krijuar prej tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë përbarimore.

2. Përbaruesi gjyqësor privat krijon arkivin në çastin që fillon ushtrimin e veprimtarisë përbarimore, në përputhje me kërkesat e këtij urdhri dhe me parashikimet ligjore në fuqi.

3. Përbaruesi gjyqësor privat kujdeset për administrimin e arkivit nëpërmjet aplikimit të rregullave të unifikuara për krijimin, përdorimin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit që merret apo prodhohet në përmbushje të veprimtarisë përbarimore të përbaruesit gjyqësor privat, si dhe sigurimin e aksesit për palët e interesuara.

4. Përbaruesi gjyqësor privat mban arkivin e tij në zyrën ku ushtron veprimtarinë përbarimore. Përbaruesi gjyqësor privat kujdeset dhe siguron ruajtjen e arkivit në ambiente të sigurta, që plotësojnë kërkesat e ruajtjes së dokumenteve nga dëmtimet e agentëve atmosferikë, biologjikë ose ndërhyrjet e personave të paautorizuar. Ambientet pajisen me mjetet mbrojtëse nga zjarri dhe nga dëmtuesit e tjerë fizikë e biologjikë.

5. Arkivi i përbaruesit gjyqësor privat përbëhet nga:

a) regjistrat e regjistrimit të çështjeve përbarimore mbi të cilët nuk mund të bëhen më regjistrime;

b) kopje fizike të raporteve statistikore vjetore të veprimtarisë së përbaruesit gjyqësor privat;

c) dosjet e çështjeve përbarimore të ekzekutuara tërësisht apo të pushuara sipas parashikimeve në fuqi të Kodit të Procedurës Civile, të cilat përfshijnë:

i. çdo dokument të prodhuar nga përbaruesi gjyqësor privat, në përmbushje të procedurës së ekzekutimit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile;

ii. çdo dokument i korrespondencës së përbaruesit gjyqësor privat me institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë dhe juridikë, prodhuar prej tyre për qëllim të procedurës së ekzekutimit; si dhe

iii. çdo dokument tjetër të ndërlidhur me procedurën e ekzekutimit;

ç) çdo dokument të prodhuar nga përbaruesi gjyqësor privat në përmbushje të veprimtarisë dytësore, sipas parashikimeve të ligjit dhe të akteve nënligjore në fuqi.

6. Përbaruesi gjyqësor privat është i detyruar të ruajë në arkiv një njësi origjinale të çdo dokumenti që prodhon në përmbushje të veprimtarisë përbarimore, si dhe kopje të çdo dokumenti që nxirret nga institucionet përgjegjëse dhe personat fizikë dhe juridikë për qëllime të procedurës së ekzekutimit.

7. Dosjet e çështjeve përbarimore, sipas shkronjës “c”, të pikës 5, të këtij urdhri, si dhe çdo dokument i prodhuar nga përbaruesi gjyqësor privat në përmbushje të veprimtarisë dytësore sistemohen në arkiv, të ndara në vite. Për përcaktimin e vitit, përbaruesi gjyqësor privat bazohet në vitin e bërjes së kërkesës nga ana e palës kreditore/palës së interesuar pranë përbaruesit gjyqësor privat, për ushtrimin nga ana e tij të veprimtarisë parësore dhe të veprimtarisë dytësore. Dosjet e një viti duhet të sistemohen sipas rendit kronologjik, duke u vendosur në rafte sipas muajve.

8. Dokumentacioni i administruar në dosje, i cili pasqyron në mënyrë kronologjike të gjithë procesin e ndjekur nga përbaruesi gjyqësor privat, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasqyrohet në fletën e pasqyrës së dokumenteve të dosjes, të ngjitur në pjesën e brendshme të kapakut të dosjes.



Përmbaruesi gjyqësor privat përcakton në këtë fletë-pasqyrë datën e arkivimit, afatin e ruajtjes dhe nënshkrimin.

9. Afati i ruajtjes në arkiv është si më poshtë:

a) regjistrat e regjistrimit të çështjeve përmbarimore, mbi të cilët nuk mund të bëhen më regjistrime, ruhen në ruajtje të përhershme;

b) raportet statistikore vjetore të veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat ruhen në ruajtje të përhershme;

c) dosjet e çështjeve përmbarimore të ekzekutuara tërësisht apo të pushuara sipas parashikimeve në fuqi të Kodit të Procedurës Civile ruhen për një afat 10 (dhjetë) vjet nga dita e arkivimit;

ç) çdo dokument i prodhuar nga përmbaruesi gjyqësor privat, në përmbushje të veprimtarisë dytësore, sipas parashikimeve të ligjit dhe të akteve nënligjore në fuqi ruhen për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar) nga dita e arkivimit.

10. Arkivi i përmbaruesit gjyqësor privat administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga vetë përmbaruesi gjyqësor privat, personat e parashikuar me ligj ose personat e autorizuar me shkrim nga përmbaruesi gjyqësor privat dhe nën mbikëqyrjen e tij.

11. Përmbaruesi gjyqësor privat është përgjegjës për çdo dëmtim të arkivit që është shkaktuar nga mosrespektimi i detyrimeve të parashikuara në këtë urdhër.

12. Përmbaruesi gjyqësor privat është i detyruar që në përputhje me legjislacionin në fuqi, t'iu sigurojë akses palëve dhe pjesëmarrësve në veprimtarinë përmbarimore, duke marrë parasysh edhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

13. Në rast se, për nevoja të procesit hetimor apo gjyqësor, përmbaruesit gjyqësor privat i kërkojnë nga prokuroria apo gjykata dokumente të arkivit, ai është i detyruar t'ia japë ato personit të ngarkuar nga gjykata ose nga prokurori. Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor privat mban një njësi origjinale të procesverbalit të dorëzimit të dokumenteve, të nënshkruara nga ai dhe personi i autorizuar nga organet e mësipërme për marrjen e dokumenteve në dorëzim. Një njësi të procesverbalit e mban personi të cilit i dorëzohen dokumentet. Njësisë së procesverbalit, që mban përmbaruesi gjyqësorë privat, i bashkëlidh edhe dokumentin që përmban urdhërimin për dorëzimin

e dokumenteve, si dhe kopje të dokumentacionit të dorëzuar.

14. Dokumentacioni i krijuar në përmbushje të veprimtarisë përmbarimore përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri, i cili përbën arkiv sipas përcaktimit të pikës 5, të këtij urdhri, bëhet pjesë e arkivit. Organizimi, mbajtja dhe administrimi kryhet në përputhje me dispozitat e këtij urdhri brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e tij.

15. Mosplotësimi i rregullave të parashikuara në këtë urdhër përbën shkak për ecurinë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

16. Për zbatimin e parashikimeve të këtij urdhri ngarkohen përmbaruesit gjyqësorë privatë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËRI DREJTËSISË

Etilda Gjona (Saliu)

URDHËR

Nr. 244, datë 21.7.2020

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT, KOPSHTI “MEHMET AKIF”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Mehmet Akif”, Tiranë, hapur me urdhër nr. 236, datë 20.6.2006 të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar: - Kopshti ‘Mehmet Akif’”, në emër të fondacionit “Gulistan”, përfaqësuar nga z. Hayrettin Ozkul.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Mehmet Akif”, Tiranë, ka këto detyrime:

a) të kthejë pagesat e kryera për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj tyre;



b) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e fëmijëve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Mehmet Akif”, Tiranë;

c) Të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të administrojë dokumentacionin e depozituar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Mehmet Akif”, Tiranë.

4. Urdhri nr. 236, datë 20.6.2006, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për funksionimin e institucionit arsimor privat parauniversitar: - Kopshti ‘Mehmet Akif’”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Mehmet Akif”, i subjektit fondacioni “Gulistan”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR

Nr. 144, datë 27.7.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 13, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 7, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, të ndryshuar, nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për procedurat e prokurimit publik, te znj. Laerta Rooze, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Albana Shtylla

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 420 lekë